



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie
Ndërkombëtare”,
Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc.Dr. Elda Zotaj

2. Prof. Asoc.Dr. Ilirjana Kaceli

Dhjetor /2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në :
“Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie
Ndërkombëtare”

1	IAL aplikues:	Universiteti BARLETI
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 241, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
E	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	n/a
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	n/a
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21-22: 9 PAE / 1 PAK 22-23: 7 PAE / 5 PAK 23-24: 6 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	21-22: 3 studentë 22-23: 1 studentë 23-24: 0 student
19	Komente / të tjera:	

- Në 2 vitet e fundit programi nuk ka patur asnjë studentë të regjistruar, sipas deklarimeve dhe komunikimit me IAL, procesi i akreditimit do bëhet vetëm për studentët aktiv në sistem të regjistruar në vitin akademik 2021- 2022 dhe më pas ky program do të mbyllet.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof. Asoc. Dr. Elda Zotaj** dhe **Prof. Asoc. Dr. Ilirjana Kaceli**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Anilda Beqiraj, përfaqësuese e ASCAL. Përgjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga grupi i vlerësimit të brendshëm për këtë proces vlerësimi.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat 26 dhe 27 qershor 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL. Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi i studimit të ciklit të parë bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si edhe ofron sugjerime/ rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të rinj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, që ofrohet nga Universiteti “Barleti” është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe ofrohet nga Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit.

Programi është licensuar në bazë të Urdhërit Nr. 241, datë 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Programi është për herë të parë në proces akreditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me 180 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 3 vite akademike.

Programi i studimit të ciklit të parë bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, i përket nivelit të 6-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Universiteti Barleti është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.11.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 45/32, datë 25.11.2024. Institucioni njofton në ASCAL më datë 03.12.2024, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 1565, datë 03.12.2024. *Kthim përgjigje mbi mbi DRVJ e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile..*

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” i ofruar nga Universiteti “Barleti” (UniBa), ofrohet në përputhje me interesat kombëtare. Në Statutin e UniBa, në nenin 4 dhe 5 shprehet qartë misioni dhe vizioni i tij duke dëshmuar se programi i studimit është në harmoni dhe në mbështetje të interesave kombëtare të vendit. Statuti dhe rregullorja e institucionit thekson se interesi i UniBa është për të promovuar frymën e lirë dhe përgatitjen e individëve të angazhuar dhe profesionistë. Ky program vjen në përputhje dhe me dokumente të tjera strategjike të institucionit si “Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030”. Vlen të përmendim se nenin 3 të statutit (Parimet Bazë) thuhet se: “Institucioni zhvillon aktivitetin e tij bazuar në respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor, kërkimor – inovativ dhe në krijimtari e programeve të ndryshme zhvillimore në kuptimin që shpreh ligji...”. Programi në përmbajtjen e tij bazohet në modele profesionalizmi dhe qytetarie nëpërmjet edukimit ndërdisiplinor të profesionistëve në fushën e politikës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe administrimit publik. Programi i studimit është është në linjë edhe me zhvillimet më të rëndësishme që po kalon vendi, ku nevojiten specialist të shkencave politike të profilizuar në drejtime si administrimi publik apo marrëdhënieve ndërkombëtare për tju përgjigjur proceseve të integritimit evropian.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Institucioni e realizon aktivitetin bazuar në respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor, kërkimor dhe inovativ (Neni 3 Statutit). Filozofia e institucionit vendos “Studentin në qendër” (Shtylla e dytë nga 5 të tilla që ka UniBa), duke kombinuar</p>


	<p>eksperiencen aktive në praktike profesionale dhe kerkim shkencor. Programi i studimit është në përputhje me qëllimin dhe misionin e universitetit Barleti të parashtruar në dokumentet themelore të tij si: Statuti i Universitetit Barleti, Rregullore e Universitetit Barleti si dhe në Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është hartuar në përputhje me strategjinë e institucionit dhe në zbatim të akteve rregullatore të tij. Ai është i ndërtuar në përmbushje të objektivave për formimin akademik të studentëve bazuar në njohuritë bashkëkohore dhe praktikatat e mira në këtë fushë në përputhje me kontekstin e zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe më gjërë.</p> <p>Në nenin 3, të Rregullores së Programit përcaktohen objektivat e programit si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. përgatitjen e studentëve duke filluar, që nga lëndët e formimit bazë deri tek lëndët me të shtjelluara dhe më specifike në fushën e administrimit public dhe marrëdhënieve ndërkombëtare b. zotërimin e shkencës së qeverisjes dhe administrimit publik, por edhe të marrëdhënieve ndërkombëtare sin ë aspektin teorik ashtu dhe në atë të zbatimit praktik; c. Integrimin e mësimdhënies, kërkimit dhe praktikës mësimore në mënyrë të tillë që të pasurojnë përvojën e të nxënit. <p>Njësia kryesore që ofron këtë program është Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe njësia bazë Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030 Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UniBa është institucion jopublik i cili prej më shumë se 19 vitesh ushtron aktivitetin në fushën e arsimit të lartë. Ky institucion ka në përbërje katër fakultete si: Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative; Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Programi bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”</p>

	<p>ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD). Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit për vitin akademik 2021 – 2022 ka në përbërje 7 anëtar. Përsa i përketë titujve dhe gradave të stafit të brendshëm të departamentit janë si vijon: 1 Prof.Asoc, 2 DR dhe 4 MSC. Për vitin akademik 2022-2023 stafi i departamentit përbëhet nga 8 anëtar me tituj dhe grada si vijon: 2 Prof.Asoc, 2 DR dhe 4 MSC. Për vitin akademik 2023-2024 stafi i departamentit përbëhet nga 7 anëtar me tituj dhe grada si vijon: 1 Prof.Asoc, 2 DR dhe 4 MSC.</p> <p><i>Në të ardhmen rekomandohet që stafi i departamentit të realizohet me tituj dhe grada më të larta në mënyrë që të ofrohet një standard më i lartë akademik.</i></p> <p>Referencat Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB Evidenca A.1.6.1, Lista e Stafit Akademik me Kohë të Plotë</p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Ky program ka përputhje të plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. Programi klasifikohet në nivelin 6 të kornizës kombëtare të kualifikimeve. Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit, sistemit evropian të transferimit të krediteve dhe në harmoni me kuadrin ligjor vendas.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.20, Prot. 431 (Dt. 27.03.2023) MAS - Dërgohet përgjigja për kodifikimin e programeve Evidenca A.2.2, Rregullore FEQD. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përsa referuar më lart, institucioni i arsimit të lartë, i cili ofron programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, përmbushur plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe inovatore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>




Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti, rregullorja e institucionit dhe aktet e brendshme përcaktojnë dhe dispijlojnë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij. Në këto dokumente, janë të përcaktuara rolet dhe përgjegjësitë respektive të drejtuesit të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, përgjegjësit e grupit mësimor/kërkimor apo koordinatorit të programit etj. Institucioni ka të përcaktuar dhe është e qartë ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Pësha kryesore për realizimin e programit të studimit mbahet nga njësia bazë që është Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, gjithashtu dhe njësitë e tjera përgjegjëse për cilësinë, karrierën apo etiken kanë rol në implementimin e programit. Departamenti ka hartuar rregullore për këtë program studimi (Ev A.2.4).</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka një politikë të hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar UniBa ka lidhur marrëveshjet bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Gjithashtu institucioni ka një strategji të ndërkombëtarizimit dhe realizon një raport mbi përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel program studimi. Nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit dhe memorandumeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private UniBa mundëson realizimin e praktikave profesionale te studenteve, angazhimin vullnetar të studentëve në komunitet, vizita studimore, si edhe aktivitete të përbashkëta. Marrëveshjet me IAL të ndryshme ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në projektet Erasmus+, ka mundësuar në nivel njësie bazë për stafet akademike dhe studentët përfitim në kuadër të mobiliteteve dhe shkëmbim eksperiencash. Në këtë program studimi përgjatë vitit 2022-2023 kanë realizuar praktikën pranë Institutit shqiptar për çështjet (AIPA) publike 3 studentë.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.1.25, Strategjia e Ndërkombëtarizimit 1. Evidenca A.1.3, Evidenca A.1.25.2, Relacion Përfitimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>

	<p>Evidenca A.1.25.1, Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të Erasmus +.</p> <p>Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit</p> <p>Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe jopublike që ndihmojnë studentët për kryerjen e praktikës. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e praktikës. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, më konkretisht Evidenca A.1.25.2 “Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit “Bachelor” në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” rezulton së përftimet që merren nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit lidhen me mundësitë e ofruara për realizimin e praktikës mësimore për realizimin e objektivave dhe aftësimin profesional të studenteve etj. Gjithashtu institucioni ka hartuar dokumente që rregullon procedurën e organizimit të praktikës. Paketa e praktikës përmban procedurat që duhet të ndiqen dhe rolin e aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Ky dokument përshkruan marrëdhënien me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat si dhe në mënyrë të detajuar formatet e raportimit dhe të vlerësimit për këtë proces, ku janë përcaktuar qëllimet dhe aftësitë e synuara, detyrimet e studentit, pedagogëve supervizues dhe institucioneve pritëse. Në vitin 2023-2024 kanë realizuar praktikën pranë realizuar praktikën pranë Institutit shqiptar për çështjet publike.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.1.3, Evidenca A.1.25.2, Relacion Përfitimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>UniBa ka marrëveshje zyrtare me një sërë aktorë e institucione për kryerjen e praktikave, në përputhje me natyrën specifike të programit. Përftimet nga këto marrëveshje janë në radhë të parë përmes bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të eksperiencave mes palëve. Ato krijojnë mundësi që studentët të zhvillojnë praktikat profesionale pranë këtyre institucioneve, si dhe japin mundësinë e shkëmbimit të stafeve akademike për shkëmbim eksperiencash me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni ka një procedurë të miratuar ku detajohet procesi i realizimit dhe mbikqyrjes së praktikës mësimore. Nga raporti rezulton së përftimet që merren nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit lidhen me trajnimet e ndryshme, leksionet e hapura, konsulencat e vazhdueshme midis paleve për realizimin e objektivave dhe aftësimin profesional të studenteve, mundësitë e punësimit të studentëve, etj</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.1.3, Evidenca A.1.25.2, Relacion Përfitimi mbi</p>



	marrëveshjet e bashkëpunimit. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor.			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimin në institucion, konkludon se njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit sigurojnë marrëdhënie dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me partnerë ndërkomëtare dhe kombëtarë për realizimin sa më efektiv të këtij programi. UniBa siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit dhe realizon raporte mbi përfitueshmërinë nga këto bashkëpunime. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunuese në kuadër të realizimit të kërkesave që ka programi i studimit për realizimin e praktikës mësimore etj. Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në total me 180 ECTS. Programi i studimit reflekton qartë elementët e duhur të strukturës së një programi të studimi bachelor. Ai realizohet në 6 semestra përgjatë 3 viteve akademike. Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Kjo ndarje respekton plotësisht legjislacionin kombëtar Ligj Nr. 80/2015, datë 25.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të

	<p>Lartë”, dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofron njohuri themelore teorike dhe praktike, ku ndërthuren njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në kategorinë A, me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në kategorinë B si dhe ndërdisiplinore dhe plotësuese me lëndët e kategorisë C dhe D. Ndërthurja e komponentëve teorik me ato praktik, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e shkencave politike sipas profilizimeve respektive. Formimi i studentet me aftësi profesionale në Shkenca Politike synohet si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik, nëpërmjet lëndëve të tilla si: E drejtë publike, Sociologji, Teknologji Informacioni, Parimet e ekonomise etj realizohet një formim bazë dhe me lëndë të tilla si: Histori e mendimit politik dhe institucioneve, Hyrje në Shkenca Politike; Marrëdhënie ndërkombëtare, Organizata ndërkombëtare, Qeverisje dhe zhvillim i qëndrueshëm; Metodat e Analizës Politike; Të Drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj synohet një formim më i profilizuar. Gjithashtu lëndët me zgjedhje si dhe praktika realizojnë një gërshetim të njohuriv specifike në funksion të zhvillimeve ekonomike apo/dhe shoqërore, por edhe të tregut të punës. Përfshirja e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare të UniBa pasuron ofertën e formimit profesional të programit për studentët. Programi i studimit synon që nëpërmjet trupës së lëndëve si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve njohuri sa më koherente gjithëpërfshirëse dhe terminologjinë e duhur që ju duhet në formimin e tyre profesional.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi me lëndët përbërëse është organizuar sipas kategorive (A-E), në përputhje me shtojcën I të VKM Nr. 41, date 24.01.2018 "Per elementit e programeve të studimit të ofruara nga IAL." Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite në vit. Programi mësimor dhe syllabuset respektojnë standartet e shpërndarjes së krediteve: 1 kredit = 25 orë, orë mësimore në auditor, ku përfshihen aktivitete të tilla si leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës, si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p>

	<p>Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për çdo kategori nga A-E. Në mënyrë specifike, në këtë program ofrohen:</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (30 ECTS; 16.6%) (VKM nr. 41/2018 15%-20% kredite)</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (96 ECTS; 53.3%) (VKM nr. 41/2018 50%-55% kredite)</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (22 ECTS; 12.2%) (VKM nr. 41/2018 12%-15% kredite)</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (24 ECTS; 13.3%) (VKM nr. 41/2018 10%-15% kredite)</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (8 ECTS; 4.4%) (VKM nr. 41/2018 3%-5% kredite)</p> <p>Përqindja e dy kategorive A dhe B është më pak se 70% konform kërkesës së VKM-së. Gjithashtu, totali i krediteve për të gjitha modulet e kategorive nga A deri në E është 180 ECTS.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Praktika ka 12 ECTS dhe bënë pjesë në kategorinë D, ndërsa detyrime përmbyllëse në kategorinë E dhe kanë 8 ECTS. Në lidhje me këto detyrime institucioni vë në dispozicion të studentëve dy dokumente të rëndësishme: “Paketën e praktikës për programin bachelor” dhe “Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor”</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse,</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore respektive. Bazuar në RVB dhe dokumentin evidenca A.1.21, institucioni ka të përcaktuar hapat e aplikimit nga maturantët/kandidatët”. Kjo procedurë dhe kriteret për pranimit në këtë institucion janë konform dhe në zbatim të udhëzimeve të MAS dhe bazës rregullative të tij dhe bëhen publike. Senati i universitetit</p>

të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	miraton me vendim kriteret e pranimit për çdo program studimi në ciklet që ofrohen këto studime.			
	Referencat Evidenca A.1.21, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve. Vendime Senati per Kriteret e Pranimit te Studenteve ne Vite.			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.			
	Referencat RVB			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni në zbatim të Udhëzimit nr.31 datë 15.11.2022, “Për Procedurat Për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr.288, datë 11.05.2022 dhe VKM nr.310, datë 11.05.2022 ka marr masat dhe ka pajisur këtë program studimi me kodin përkatës: 63BA0312S . Institucioni ka realizuar kodifikimin e programit të studimit, si dhe ka të përcaktuar kodin me tre gërma dhe tre numra për çdo lëndë në planin mësimor.			
	Referencat RVB Evidenca A.1.20, Prot. 431 (Dt. 27.03.2023) MAS - Dërgohet përgjigja për kodifikimin e programeve.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.			
	Referencat RVB			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit është njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Ky departament është një nga tre njësitë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën dhe stafet akademike. Në vitin akademik 2023-2024, departamenti ka në strukturë 7 anëtar personel akademik me kohë të plotë, me tituj dhe grada si vijon: 1 prof. asoc; 2 me gradën Doktor Shkencash dhe 4 janë më Master Shkencor. Për organizimin e punës krahas akteve në nivel institucional, departamenti ka rregulloren e tij si dhe ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar për programin e studimit. Në këtë dokument janë të përcaktuara objektivat e programit, mënyra e organizimit të studimeve, politika e frekuentimit, plani mësimor etj. Departamenti drejtohet nga përgjegjësi ndërsa puna në departament koordinohet nga koordinatori i Departamentit.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.6.1, Lista e Stafit Akademik me Kohë të Plotë. Evidenca A.2.3, Rregullore e DQSHK. Evidenca A.2.3.1, Vendimi Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 Ndryshimet ne Rregullore. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Në RVB ky kriter cilësohet N/A (i pa aplikueshëm). Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ka si pjesë të planit mësimor realizimin e praktikës mësimore në vitin e tretë të studimeve. Nga njohja me dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe vizitën e realizuar në institucion, konstatohet se për realizimin e praktikës mësimore caktohet pedagogu i praktikës. Të gjitha procedurat janë të përcaktuara në paketën e praktikës.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor.</p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të	<p>Kuadri ligjor i institucionit përcakton funksionet dhe detyrat e drejtuesit të Departamentit dhe koordinorit të departamentit (Statuti, Rregulloret, Vendimi i Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 Ndryshimet ne Rregullore” përcakton pozicionin e “koordinorit të departamentit). Drejtuesi i Departamentit mbikqyr veprimtaritë</p>

<p>programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>mësimore shkencore, monitoron procesin e përgatitjes në përputhje me planin mësimor etj, ai është hallka lidhëse midis departamentit dhe dekanit duke përcjell propozimet e njësisë bazë. Sipas përcaktimit të nenit nr.6 të rregullores së institucionit koordinatori i departamentit kryen dhe detyrën e koordinatorit të programeve të studimit. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit, dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit dhe raporton tek drejtuesi i departamentit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.2, Rregullore FEQD. Evidenca A.2.3, Rregullore e DQSHK. Evidenca A.2.3.1, Vendimi Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 Ndryshimet ne Rregullore Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër në lidhje me respektimin e kuadrit rregullator në të gjitha nivelet. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit si njësi bazë ku ofrohet programi i studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe funksionojnë duke përmbushur detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, për vlerësimin dhe akreditimin e programit në tërësi, për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve si dhe me institucionet jashtë tij për realizimin e praktikave të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit të programit të studimit, takimeve në UniBa dhe dokumentave shtesë, grupi i ekspertëve të jashtëm thekson se Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe rregullores së programit të studimit.</p>




	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në tre vite akademik, të ndarë në dy semestra. UniBa ka një sistem digital online “INTRANET” për çështjet akademike të studentëve. Sistemi ndër të tjera përmban: lëndët, silabuset, materialet e studimit, oraret mësimore etj</p> <p>Referencat Evidenca A.2.3, Rregullore e DQSHK. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ndërkohë, në rregulloren akademike të institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.3, Rregullore e DQSHK. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka një kuadër të plotë rregullator që lidhet me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ato janë të përcaktuara në dokumente rregullator të UniBa në të gjitha nivelet, dhe në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në dokumentin “Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve” përcaktohet politika e pranimit të studentëve, procedurat dhe dokumentacionet që nevojiten për transferimin etj. Në UniBa nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, studentët e UniBa-s, por dhe ata potencialë informohen dhe orientohen në lidhje me kriteret e pranimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve dhe/ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të studimeve.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.3, Rregullore e DQSHK. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.1.21, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e</p>	<p>Programet lëndore (syllabuset) që përmban kurrikula e programit të studimit janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të</p>

<p>nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>strukturuara sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni. Ato përmbajnë informacion i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Gjithashtu në çdo fillim viti akademik nga stafi akademik rishikohet përmbajtja e programeve lëndore të programit të studimit. Referuar kërkesave të VKM Nr. 41/2018, (i ndryshuar) Syllabusi përmban gjithë informacionin e nevojshëm për lëndën respektive në çdo semestër studimi dhe për çdo vit akademik që ofron program i studimit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB.</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ky program studimi është për herë të parë në proces akreditimi, ndaj nuk ka patur përditësime, por në fillim të çdo viti akademik stafi rishikon programet lëndore për të realizuar përditësime të nevojshme. Duhet thënë se, institucioni ka një dokument të titulluar “Manual i hartimit / riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit” që përmban praktikën dhe procedurën për rishikimin sipas rastit të programeve të studimit. Sipas akteve nënligjore institucioni ka të drejtë të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 % pas akreditimit të programit</p> <p>Referencat Evidenca A.1.19, Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të studimit. Plani Mësimor i programit dhe Syllabuset e lëndëve ofrojnë si në përmbajtje, edhe në formë të gjithë informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke respektuar si aspektet ligjore edhe rregulloret e brendshme të institucionit mbi kriteret e pranimit dhe transferimet e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” konstatohet se emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse sipas dy profileve, për të vijuar në vitin e fundit me praktikën mësimore dhe detyrimet përmbyllëse. Ky program studimi është i përshtatshëm për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të vijuar më tej në programet e studimit Master i Shkencave apo programe të tjera të ciklit të dytë me përmbajtje dhe disiplinë të njëjtë e të afërt.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Vlerësohet se struktura, organizmi dhe përmbajtja e programit të studimit, mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” të përcaktuar në rregulloren e tij. Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 6 semestra të shtrira përgjatë 3 viteve akademike, me kreditet e orët mësimore përkatëse, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit të studentëve. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit klasifikimi i veprimtarive formuese në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse mundëson më së miri arritje dhe përmbushje efikase të objektivave formuese të programit të studimit duke i aftësuar studentët me njohuri që reflektojnë zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave politike sipas profileve respektive.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e “Shkencave Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Programi përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme</p>

<p>programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>(kryesisht lëndët teorike), por ka dhe risi përsa i takon lëndëve të profileve respektive që vijnë në vitin e dytë dhe në vitin e tretë.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” si: rregullore e programit të studimit, plani mësimor, dhe programet lëndore, rezultojnë se ka një raport të mirë mes formimit teorik dhe atij praktik dhe kuadri i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimin të studentëve për tregun e punës. Ndërtimi i programit mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.1.21, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se syllabuset e të gjitha lëndëve janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në parim, funksionon që në fillim të çdo viti akademik pedagogëve u kërkohet përditësimi i syllabuseve. Referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj ka nevojë që në disa lëndë të azhurnohet aty ku është e mundur psh lëndë si: E-Qeverisja; Hartim dhe menaxhim i projekteve; Histori e Institucioneve Politiko-Juridike etj) me literaturë të 5 viteve të fundit me profilin specifik lëndor.</p> <p>Tëresia e kompetencave që kërkohet nga tregu i punës për të diplomuarit e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është përcaktuar në mënyrë të plotë në Rregulloren e Programit të Studimit ku përcaktohen objektivat specifik formuese të tij.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të</p>



dhe kompetencave të synuara.	<p>këtij programi (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik). Fokusi i studimit të programit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është marrja e njohurive të thelluara në këtë fushë dhe përmbajtja e programit ofron fitimin e njohurive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Mendimi i Dekanit</p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të dytë, sikurse dhe mundësinë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Lëndët e këtij programi i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e shkencave politike sipas profileve si dhe me aftësi për kërkimin shkencor, një element i rëndësishëm kryesisht për studentët që synojnë vijimin e programeve Master i Shkencave apo edhe avancime të mëtejshme.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ pas takimeve me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, me drejtuesin e departamentit, dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit sikurse edhe pas shqyrtimit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e “Administrimit Publik” dhe “Marrëdhënieve Ndërkombëtare” e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në planin mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe element të kërkimit shkencor. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të këtij programi bachelor njohuri dhe përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme. Lëndët karakterizuese janë lëndë që i ofrojnë përgatitje të thelluar sipas dy profileve të programit. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe realizohen me 180 kredite.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji, etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimin të përmbajtjes së programeve të studimit. Programi është një program i ri dhe si i tillë është hera e parë që është në proces akreditimi. Gjithsesi, instrumentat dhe baza ligjore ku funksionon departamenti e përcakton atë si njësi përgjegjëse për nisjen e këtij procesi për realizimin e përmirësimin të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni ka infrastrukturën dhe strukturat përgjegjëse që të asistojnë departamentin për ndërmarrjen e një procesi të tillë.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.3.2, Plani Strategjik për Zhvillimin e DQSHK. Evidenca A.1.24.5, Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të institucionit 2020-2030” përcaktohet si moto e UniBa “Studenti në qendër” duke reflektuar më së miri atë çka studentët përfaqësojnë për institucionin. E gjithë veprimtaria e institucionit fokusohet në krijimin e infrastrukturës akademike dhe kushteve optimal për formimin e studentëve në të gjitha programet e studimit që institucioni ofron. Departamenti realizon një punë përfshirëse me studentët përmes takimeve periodike me ta. Studentët janë të përfshirë në komunikime të vazhdueshme me stafin akademik të departamentit për përmirësimin e realizimit të programit të studimit, dhe gjatë takimit me studentët na u konfirmua përfshirja dhe komunikimi i afërt që ata kishin me stafin dhe drejtuesit e departamentit.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030. Evidenca A.1.10.3, Raport i Vlerësimit të Studentëve, V.A. 2022-2023. Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete</p>	<p>UniBa ka infrastrukturën dhe mekanizmat e bashkëpunimit me rrjete profesionistësh, shoqata, dhe institucione publike e private për të marrë feedback që lidhet me nevojat për të përshtatur programet e studimit me dinamikën e reja dhe propozimet e ardhura prej tyre. Departamenti ka realizuar një studim tregu tejet kompleks për këtë program studimi, duke evidentuar një mori aspektesh të nevojshme për të ardhmen e tij. Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike</p>



profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	dhe Komunikimit si njësi përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi disponon dokumentacion dhe mban marrëdhënie me institucionet partnere dhe rrjete profesionistësh që operojnë në institucionet e vendit. Mendimet dhe sugjerimet e tyre janë të rëndësishme në hartimin e programit dhe merren në konsideratë në rast të përditësimit dhe përshtatjes së programit.			
	Referencat Evidenca A.2.3.2, Plani Strategjik për Zhvillimin e DQSHK. Evidenca A.2.6, Studimi i Tregut të Punës. Evidenca A.2.7, Ngritja e Bordit të Karrierës në DQSHK.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Strukturat drejtuese në nivel njësie kryesore dhe bazë e vlerësojnë bashkëpunimin me institucionet partnere në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikën profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Stafi i departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit për realizimin e programit të studimit përpunon të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive Rregullorja e programit të studimit, plani mësimor dhe programet lëndore parashikojnë se gjatë mësimdhënies, të përfshihen të gjithë elementët formues në funksion të studentit si: leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet dhe detyrat e kursit, praktika profesionale, përgatitja e mikrotezës.</p> <p>Ndarja e tyre është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Leksione – 800 orë mësimore 2. Seminare – 371 orë mësimore

	<p>3. Projekte/detyra kursi – 27orë mësimore 4. Praktika – 270 orë mësimore 5. Provë finale – 28 orë mësimore</p> <p>Programi i lëndës jep informacion mbi titullarin e lëndës, ngarkesën (në ECTS dhe orë mësimore), vitin akademik/ semestrin kur zhvillohet, kategorinë dhe llojin e lëndës, kontaktet e titullarit; përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet; konceptet themelore; temat e lëndës dhe metodat pedagogjike për seminarin/laboratorin; format e kontrollit të dijeve; literaturën bazë të detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar; vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës. Institucioni ka hartuar një dokument të titulluar “Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie” i cili shërben për të orientuar stafin akademik në procesin e lektrimit dhe jo vetëm. Format e kontrollit të dijeve të studentëve realizohet bazuar në komponentë të tillë si provimet, pjesëmarrja dhe aktivizimi i studentit në orët mësimore, realizimi dhe prezantimi i detyrave të kursit, mbyllja e detyrimeve të praktikës profesionale, dhe detyrimet përmblyëse. Çdo syllabus ka të përcaktuar format e vlerësimit të studentëve. Vlerësimi përfundimtar merr në konsideratë të gjithë përbërësit e vlerësimit të studentëve dhe rezultatin e provimit përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit të kursit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.16, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentë të këtij programi studimi u konstatua se stafi është në kontakt të vazhdueshëm. Stafi akademik punon për të nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e gjithsecilit student duke ruajtur edhe natyrën e veprimtarive formuese që ky program studimi ofron. Institucioni ka dy dokumente ku orienton stafin akademik mbi format e metodave të mësimdhënies, ato janë: Udhëzues për metodat e mësimdhënies dhe Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie. Gjithashtu, institucioni ka dhe infrastrukturë teknologjike me të cilën janë të pajisura sallat e leksionit dhe i mundësojnë stafit akademik dhe studentëve gjithashtu aplikimin e përdorimit të videove ilustruese, prezantimeve në ppt etj.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.15, Udhëzues për metodat e mësimdhënies. Evidenca A.1.16, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni</p>	<p>Filozofia e institucionit dhe strukturat e tij mbështesin rritjen</p>

<p>mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>akademike dhe zhvillimin e metodave të suksesshme mësimore për stafit akademik. Struktura brenda universitetit asistojnë stafin me udhëzues dhe manuale përsa i takon politikave të mësimdhënies por edhe përdorimit të teknologjisë. Institucioni ka një politikë mbështetëse për personelin e tij akademik me asistencë logjistike (kompjuter dhe pajisje të tjera plotësuese), me trajnime informuese mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit. Këto trajnime kanë lehtësuar ndjeshëm përdorimin e formave të reja didaktike në shërbim të mësimnxënies dhe në arritjen e objektivave formues.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.15, Udhëzues për metodat e mësimdhënies. Evidenca A.1.16, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie. Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit është me përvojë në mësimdhënie dhe ka kualifikime shkencor duke qenë kompetent për lëndët dhe modulet që zhvillon në dhënien e njohurive në kuadër të këtij programi studimi. Institucioni ka dhe një politikë të zhvillimit shumë dimensional të stafit akademik. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe infrastrukturën që ka institucioni, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin përmes nxitjes së mendimit krijues dhe zhvillimit të përgjithshëm të tij. Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i përfshirë në aktivitete akademike dhe shkencore.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.15, Udhëzues për metodat e mësimdhënies. Evidenca A.1.16, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie. Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar praktika periodike vlerësimi në nivele të ndryshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe ruajtjen e cilësisë. Bazuar në aktet rregullative bazë të KUB, Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë harton në mënyrë periodike dokumentin me titull “Plan pune NJZKC”.</p> <p>Njësia bazë, realizon monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Vlerësimi bëhet nëpërmjet vlerësimit peer to peer mes kolegëve, pytesorëve të studentëve që hartohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë, si dhe vlerësimet vjetore që bëhen nga përgjegjësi i njësisë bazë.</p>

	<p>Referencat Evidenca A.1.10, Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë. Evidenca A.1.11, Manuali i Cilësisë. Evidenca A.1.12, Plan Pune NJZHKC. Evidenca A.1.10.2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën. Evidenca A.1.10.3, Raport i Vlerësimit të Studentëve, V.A. 2022-2023.</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Procesi i monitorimit të programit të studimit realizohet si në nivel institucional, njësie kryesore dhe atë bazë Statuti i universitetit ka të përcaktuar struktura të cilat realizojnë monitorimin për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor. Në nenin 28 të Statutit përcaktohet Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC) i cili është një komision i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim, dhe mbështetje në hartimin e politikave të të procedurave të sigurimit të brëndëshëm të cilësisë. KSSC mbështet Njësia e Zhvillimit Kurrikularë dhe të Cilësisë për të përmbushur funksionet e saj lidhur me garantimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.</p> <p>UniBa organizon në mënyrë periodike trajnime me stafin akademik, kryesisht për metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies. Universiteti Barleti disponon manualin mbi procedurat e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të ndryshme për një mësimdhënie bashkëkohore, ai nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies referuar rezultateve të nxjerra nga proceset monitorim-vlerësim dhe vetëvlerësimi i vetë pedagogut.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti. Evidenca A.1.16, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në pëmbjllje të këtij standardi, GVJ konkludon se institucioni përmes stafit akademik dhe infrastrukturës mbështetëse harmonizon dhe garanton procesin e të nxënies, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin. Për garantimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve të studimit, strukturat respektive realizojnë disa forma vlerësimi, si për studentët, stafet apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0) 4 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit në kreun III, neni 17 përcaktohen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive profesionale. Sipas rregullores së programit të studimit testimi mund të realizohet me a) me provim me shkrim, gojë ose e kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Vlerësimi me notë realizohet nga 4(katër) deri në 10(dhjetë). Gjithashtu në nivel universiteti është Rregullorja e institucionit që përcakton procesin e testimit dhe vlerësimit të njohurive në kreun VII, neni 88 “Forma e kontrollit”. Çdo fillim viti akademik studentët informohen nëpërmjet përgjegjësit dhe koordinatorit të departamentit mbi rregulloren e programit dhe jepen shpjegimet e duhura për çdo rast. Institucioni ka procedura transparente të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përsa i përket vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Çdo syllabus ka një seksion të veçantë për mënyrën e vlerësimit të lëndës.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>												
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” i njih studentët në fillim të semestrit me syllabusin, ku theksohet mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët u konfirmua ky proces. Studentët informohen në detaje për mënyrën e vlerësimit të njohurive të tyre. Në syllabus ka një seksion të titulluar “Kontrolli i vazhdueshëm” ku janë të specifikuar sipas komponentëve testimi i njohurive dhe dijeve si në tabelën vijuese:</p> <table border="1" data-bbox="624 1541 1315 1756"> <thead> <tr> <th>Komponentët e vlerësimit</th> <th>Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Detyra e kursit</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td>TOTALI</td> <td>100</td> </tr> </tbody> </table> <p>Referencat Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>	Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	20	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10	Detyra e kursit	20	Provimi përfundimtar	50	TOTALI	100
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)												
Provimi i ndërmjetëm	20												
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10												
Detyra e kursit	20												
Provimi përfundimtar	50												
TOTALI	100												
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndë, si nëpërmjet vlerësimit formues ose të vazhduar dhe atij</p>												



<p>profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>përmbledhës. Në format e vlerësimit të vazhduar përfshihen, vlerësim për përgjigjet në seminare, aktivizimi, provim me shkrim, me detyra kursi, projekte, ese. Detyra e kursit mund të jetë: ese, punë në grup, rast studimor, projekt, prezantim, performancë sportive ose artistike, etj. Ajo përcaktohet nga titullari, në varësi të specifikave të lëndës. Pedagogu i lëndës i vë në dispozicion studentëve strukturën e detyrës së kursit, duke e orientuar secilin student për tematikën e zgjedhur. Periudha e zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, dhe periudha e zhvillimit dhe/ose dorëzimit të detyrës së kursit, vendosen në javën/të përkatëse në syllabus. Provimi i ndërmjetëm, në varësi të specifikave të lëndës/modulit, zhvillohet në javën e gjashtë ose të shtatë, dhe kontrollon njohuritë e temave të zhvilluara në pesë javët e para. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në orën e seminarit/praktikës së javës përkatëse. Vlerësimi përmbledhës realizohet me test përmbledhës në fund të vitit akademik. Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Drejtuksi i Njesisë Bazë mbikqyr dhe monitoron realizimin e procesit mësimor në programet e ofruara nga departamenti. Vlerësimi i aftësive të pedagogëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve, bëhet edhe nga studentët. Institucioni ka strukturat administrative dhe instrumentat në lidhje me marrjen e feedback-ut nga studentët për realizimin e procesit mësimor. Në nivel institucional, Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë realizon plotësimin e pyetësorëve drejtuar studentëve mbi aspekte të ndryshme të mësim-dhënies si: Organizimi i lëndës; Përmbajtja e lëndës; Materialet e lëndës; Komponentët e vlerësimit dhe aspektet pedagogjike të lektorit. Pyetësorët realizohen për çdo lëndë dhe pedagog në përfundim të semestrit. Në përfundim të këtij procesi hartohet dhe një raport me gjetjet e procesit të vlerësimit. Ky proces është i rëndësishëm pasi vlerësimet e studentëve konsiderohen për përmirësimin e metodave dhe formave të mësimdhënies në mënyrë periodike.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.10.2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën. Evidenca A.1.10.3, Raport i Vlerësimit të Studentëve, V.A. 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të</p>	<p>Universiteti Barleti ka investuar në një infrastrukturë teknologjike duke krijuar stafit akademik mundësi për përdorimin e metodave të shumëllojshme teknologjike, didaktike dhe pedagogjike. Personeli akademik pranë Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe</p>

<p>përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Komunikimit janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Ky proces udhëhiqet nga Drejtuesi i Departamentit dhe monitorohet dhe vlerësohet me kujdes. Stafëve u vihen në dispozicion udhëzues dhe manuale përsa i takon politikave të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë. Bazuar në strukturën e “kontrollit të vazhdueshëm” pjesë e silabuseve vërehet se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit përmes punës individuale që ai realizon në kuadër të çdo lënde.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni ka përcaktuar në aktet e tij rregullatore (që nga Rregullorja e Universitetit deri tek rregullorja e programit të studimit) procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Këto komponent janë pjesë e çdo syllabusi. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Stafi akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi për realizimin e procesit të vlerësimit të dijës së studentit. Vlerësimi përfundimtar i njohurive është bashkimi i vlerësimit të vazhdueshëm me vlerësimin përmbledhës, që realizohet me anë të provimit në fund të realizimit të programit mësimor të kursit. Mbështetur në syllabuset e lëndëve, vlerësimi i studentëve bëhet përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të kursit në mënyrë të vazhdueshme. Kështu, vlerësimi realizohet përmes provimit të ndërmjetëm (20 %), ndërsa komponentët e tjerë të vlerësimit vlerësohen nga pedagogu i lëndës që ka hartuar programin lëndorë në konsultim me përgjegjësin e departamentit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>

	RVB
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	N/A Referencat RVB fq.25
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Procedura e vlerësimit përfundimtar mbështet në rregulloret e UniBa. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me kategorizimet e komponentëve të vlerësimit që ka syllabusi. Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titullar dhe tjetri asistent. Në nenin 88 të Rregullores së universitetit thuhet se: “Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit të cilat pasi miratohen nga përgjegjësi i departamentit depozitohen në departament të paktën 2 ditë para provimit”. Provimet sekretohen duke i dhënë procesit paanshmëri në vlerësimin e tezës. Institucioni ka miratuar një format standard për provimet. Ky dokument i vihet në dispozicion pedagogut të lëndës. Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.8, Vendim Rektorati Nr. 94 dt. 12.02.2021 Per miratimin e formatin e provimeve.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në Rregulloren e Universitetit Barleti, neni 85; 86; 87; 88; 89 është përcaktuar procesi dhe kuadri i vlerësimit të njohurive. Vlerësimi i vazhduar i punës së studentëve zhvillohet përgjatë të dy semestrave të vitit akademik (15 javë kalendarike një semestër). Procesin e testimit është me sekretim. Në Rregulloren e Universitetit, neni 88 thuhet se: “Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vlerësimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve gjatë ditës së provimit, dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë kalendarike”. Studentët marrin komente dhe vlerësime për detyra kurse, projekte, prezantime, teste formuese shoqërohet me komente për studentin me qëllim që ai të kuptojë gjendjen dhe të nxitet për t’u përmirësuar. Për zhvillimin e testit përmbledhës zhvillohet paraprakisht seancë shpjeguese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, zhvillohet me ta model testi final dhe rishpjegohen kriteret e vlerësimit. Të gjitha këto synojnë që studenti të përmirësohet në performancën që do të paraqesë dhe të jetë i vetëdijshëm për vlerësimin. Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.8, Vendim Rektorati Nr. 94 dt. 12.02.2021 Per miratimin

	e formatin e provimeve.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Rregulloret e të gjitha niveleve institucionale dhe Kodi i etikës së UniBa, nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se infrastruktura fizike e auditoreve ku zhvillohen provimeve janë në kushte optimale. Provimi monitorohet nga stafi i departamenti (i caktuar si asistues krahas lektorit të lëndës) dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve që nuk kanë lidhje me provimin.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.1.5, Kodi i Etikës i UniBa.</p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Universiteti ka një politikë të sekretimit të fletëve të provimit duke mbështetur një vlerësim drejtë dhe në bazë të meritës. Sikundër është përmendur dhe më herët në Rregulloren e Universitetit përcaktohen afatet dhe procedura e njohjes me rezultatet akademike të studentit. Më konkretisht, provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vlerësimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve gjatë ditës së provimit, dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë kalendrike”. Vlerësimet e studentëve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit. Fleta e vlerësimit – procesverbali firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe kryesekretarja.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. RVB</p>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Në aktet rregullatore të institucionit garantohej e drejta e studentit që të njihet/ dhe ankimojë rezultatin e vlerësimit të dijeve tek çdo lëndë. Në datën e komunikuar që gjatë ditës së provimit, pedagogu i lëndës takohet me studentët ku ju komunikon rezultatin e provimit dhe pas dakordësisë, i regjistron këto rezultate në fletën e vlerësimit. Ky proces ju mundëson studentëve të njihen paraprakisht me rezultatet e tyre dhe notën përkatëse. Neni 90 “Ankimimi për vlerësimin” i Rregullores së Universitetit përcakton procedurën e rishikim të vlerësimit në rastet kur student nuk bie dakortë për mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
Kriteri 8. Çdo kërkesë,	Nga shqyrtimi i Rregullores së Universitetit (nenit 90), studenti ka të

<p>ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i paarqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës, por para shënimit të notës në Regjistrin e Arritjeve Akademike. Përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin, i cili brenda 48 orësh ngre një komision <i>ad hoc</i> për shqyrtimin e ankesës. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e tij me komisionin e miratuar nga dekanin.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet rregulloreve respektive, syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” (neni 3 “Objektivat e programit”) janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë të pajisin studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierë profesionale. Gjithashtu synohet që përmes lëndëve karakterizuese dhe atyre me zgjedhje student të pajiset me njohuri të thelluara dhe plotësuese sipas profileve respektive. Gjithashtu programi ofron njohuri të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, si edhe plotësuese. Nëpërmjet kërkimit të zhvillohet dija dhe të përmirësohet praktika.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit</p>	<p>Në programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile</p>




<p>garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>“Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” zhvillohen lëndë të cilat mundësojnë dhe garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si “Teknologji informacioni”, humane si “Sociologji”; “Antropologji sociale” etj. Kurrikula është e organizuar në mënyrë të tillë që të aftësojnë studentin dhe në drejtime më të theluara të profileve përtej fushës së Shkencave Politike, por e ndërlidhur me të.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit realizon një analizë vjetore ku synohet niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të vitit akademik, sfidat në arritjen e tyre, efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë. Forma e testimit të vazhdueshëm që bëhet për çdo lëndë mundëson vlerësimin e kompetencave dhe aftësive që merr studenti hap pas hapi përgjatë vitit akademik. Në përfundimit të lëndës pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara. Ata qartësojnë përmbajtjen mbi të cilën do të ndërtohet teza e provimit përfundimtar dhe në shumë raste zhvillojnë edhe një model teze që u shërben studentëve të njihen me treguesit kryesorë që kanë lidhje me llojin dhe numrin e pyetjeve, nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe pjesët e programit që përfaqësojnë, kohën e testit dhe mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.5, Analizë Vjetore e Punës së DQSHK. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e</p>	<p>Baza rregullative ku mbështetet funksionimi i departamentit dhe puna e stafit akademik për realizimin e programeve të studimit është e plotë dhe me kërkesa të larta në drejtim të cilësisë së mësimdhënies. GVI vlerëson se nga dokumentacioni i paraqitur nga UniBa dhe vizita në institucion rezultojnë se për realizimin e programit bachelor “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” stafi akademik angazhohet që mësimdhënia të realizohet mbi bazë kompetencash dhe t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në kontekstin teorik dhe zbatim praktik përmes praktikës mësimore. Stafi akademik për realizimin e procesit të mësimdhënies mbështetet si në aspektin teorik dhe atë praktik. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materialet shtesë, literatura e rekomanduar, apo raste studimore që mund të trajtohen në varësi të lëndës. Përfshirja e praktikës është gjithashtu një komponent i rëndësishëm për gërshetimin e njohurive me praktikën në institucione.</p>

shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Kurrikula e këtij programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, speciale dhe të transferueshme të cilat mundësojnë një formim cilësor të studentit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4.2, Programet Lëndore. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet Bachelor.</p>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Institucioni ka një praktikë të mirë organizuar lidhur me aktivitetet ekstrakurrikulare që organizohen nga stafi akademik dhe staf të ftuar. Departamenti ka një planë vjetor të aktiviteteve ku pasqyrohen personat që do të angazhohen, tematika që do të trajtohet dhe koha e realizimit. Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar leksione të hapura dhe seminare për zhvillime të reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.24.3, Strategjia e Klubeve studentore 2020-2025. Evidenca A.1.24.8, Plani i punës Dekani i studentëve 2023-2024.</p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale. Institucioni ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>Institucioni ka të përcaktuar qartë si në rregulloren e UniBa dhe atë të programit të studimit realizimin e detyrimeve përmbyllëse. Bazuar në rregulloren e institucionit, si dhe programit të studimit studentët njihen heret me këtë detyrim dhe hapat që duhen përmbushur.</p> <p>Në nenin 16 “Prova Finale” të Rregullores së Programit të studimit thuhet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Për të fituar diplomën bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” studenti duhet të ketë siguruar 180 kredite. 2- Studimet përmbyllen me provën finale që do të jetë në trajtën e

	<p>provimit të përgjithshëm përfundimtar me përjashtim të studentëve me mesatare jo më të ulët se 8, të cilët mund të zgjedhin temë diplome.</p> <p>Në rastet kur studenti nuk ka një mesatare 8 e lartë, e përfundon programin e studimit me provim përfundimtar. Departamenti ka hartuar Udhëzues për provimin e formimit. Kur studenti përgatit temë për mbrojtjen e provës finale, ky proces realizohet para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.1, Plani mësimor i programit të studimit. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, dhe më specifikisht përgjegjësi i departamentit, asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre informacion, të dhëna, udhëzime për materialet në funksion të realizimit të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit</p> <p>RVB</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Kreu IV (neni 22 dhe neni 23). Në nenin 22 është përcaktuar “Procedura e diplomimit” ku për të fituar diplomën bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, studenti duhet të ketë marrë 180 kredite. Gjithashtu përveç arritjes së rezultateve pozitive përgjatë të gjitha kurseve dhe kryerjes së praktikës, studentët duhet t’i nënshtrohen edhe provës finale e cila është në trajtën e provimit të formimit. Mbrojtja e provës finale bëhet në dy sesione: i verës dhe i dimrit të cilat përcaktohen në kalendarin akademik. Departamenti propozon komisionet të cilat duhet të jenë me jo më pak se tre anëtarë nga departamenti. Komisioni miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve,</p>	<p>Studentët me mesatare nën notën 8 I përmbyllin studimet me provën finale që është në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Studentët me mesatare mbi notën 8, mund të zgjedhin temë diplome.</p> <p>Për studimet që përmbyllet me temë diplome është përgjegjësi e udhëheqësit të diplomës t’i ofrojë studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme për të arritur standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të</p>

<p>përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësorë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, të bëjë kritikën dhe duhura për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor.</p>																
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamenti, udhëheqësit, punonjësit e bibliotekës dhe sekretaria mësiore asistojnë studentët në procesin e punës për plotësimin e detyrimeve përmbledhëse. Në varësi të temës dhe fushës së studimit institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit si brenda institucionit, edhe jashtë tij në institucionet partnere.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor. Evidenca A.1.25.2, Relacion Përfitimimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>																
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Sistemi i pikëzimit është si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="790 1243 1316 1523"> <thead> <tr> <th>Shkalla e pikëve</th> <th>Përshkrimi i notës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>96 – 100</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> <tr> <td>86 – 95</td> <td>Shumë mirë</td> </tr> <tr> <td>76 – 85</td> <td>Mirë</td> </tr> <tr> <td>66 – 75</td> <td>Kënaqshëm</td> </tr> <tr> <td>56 – 65</td> <td>Mjaftueshëm</td> </tr> <tr> <td>50 – 55</td> <td>Kalueshëm</td> </tr> <tr> <td>Me pak se 49</td> <td>Mbetës</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në rastin e punimit të diplomës vlerësimi bëhet sipas një grup komponentësh. Më konkretisht: hyrja – 10%; Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes – 20%; Metodologjia – 15%; Rezultatet e studimit – 20%; Diskutimi – 20%; Përfundime 10% dhe Literatura 5%. Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga UniBa dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës Finale për Programet Bachelor.</p>	Shkalla e pikëve	Përshkrimi i notës	96 – 100	Shkëlqyeshëm	86 – 95	Shumë mirë	76 – 85	Mirë	66 – 75	Kënaqshëm	56 – 65	Mjaftueshëm	50 – 55	Kalueshëm	Me pak se 49	Mbetës
Shkalla e pikëve	Përshkrimi i notës																
96 – 100	Shkëlqyeshëm																
86 – 95	Shumë mirë																
76 – 85	Mirë																
66 – 75	Kënaqshëm																
56 – 65	Mjaftueshëm																
50 – 55	Kalueshëm																
Me pak se 49	Mbetës																

<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti, që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur provën finale (provim formimi ose punim diplome) pajiset nga UniBa me Diplomën përkatëse, e cila shoqërohet me suplementin e diplomës. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit pjesë e të cilit është dhe departamenti që ofron programin e studimit dhe Rektori i UniBa-s. Në përfundim të studimeve, sipas kërkesë së studentit, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</p> <p>Referencat Evidenca A.2.4, Rregullore e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimin e realizuar me sekretarinë mësimore u konstatua se në arkivën e Sekretarisë Mësimore mbahen deri në përfundim të studimeve të studentit dhe pajisjes me diplomën përkatës, dokumentacioni në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Dosja personale e studentit, 2- Rregjistrat mësimorë, 3- Fletet e vlerësimit të firmosura nga Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i autorizuar i sekretarisë mësimore, 4- Regjistri i lëshimit të diplomave, 5- Rregjistrat e studentëve me të gjitha të dhënat dhe rezultatet sipas përcaktimeve të Minsitrisë përgjegjëse për arsim, kalendari akademik, planet mësimore (origjinale të dyta), 6- kopje e diplomës së lëshuar, dorëzuar nga studenti. <p>Ky dokumentacion aksesohet sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në lidhje me studentët. Tezat e provimit të studentit ruhen për një periudhë 3 mujore sipas rregullores së protokoll arkivës dhe të sekretarisë mësimore.</p> <p>Referencat Evidenca A.1.26, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore. Evidenca A.1.27, Rregullore e Protokollit dhe Arkivës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga sekretaria mësimore, stafi i departamenti ashtu edhe nga udhëheqësi i diplomës. Në përfundim të studimeve, UniBA e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë diplomën edhe suplementin.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues të paraqitur në RVB, dosjeve të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si dhe nga vizita e GVJ në Institucion u konstatua se UniBa ka personel akademik që i përmbush kriteret ligjore dhe stantartet e cilësisë për mbulimin e këtij programi.

1. Gjatë periudhës 2021-2024 stafi akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi të profilizuar është si më poshtë :i.

Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	1	1
Dr./PhD.	5	1	3	3	3	-
Msc.	3	-	2	2	2	2
Totali	9	1	7	5	6	3

Nga komunikimet e GVJ me pedagogët dhe studentët, si dhe nga vlerësimi i studentëve rezulton një vlerësim shumë i mirë për stafin akademik (Vizita në Institucion).

Referenca

Evidenca A.1.6.1, Lista e Stafit Akademik me kohë të plotë.
Evidenca A. 1. 6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
Evidenca A.6.2, Formatit i dosjes personale të stafit/
Evidenca A1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/ Tabelat nr.6.1; 6.2; 6.3 dhe tabela 7.

<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se ngarkesa e personelit akademik efektiv përfshinte mbulimin e ngarkesës mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme. Sipas udhëzimit të Rektorit bazuar në Evidencën A.1.18, lidhur me punën për ngarkesën mësimore ne shikojmë që ngarkesa mësimore përbën rreth 50% të ngarkesës së punës, kërkimin shkencor me rreth 20%, punën administrative dhe punën me studentët dhe aktivitetet që organizon UniBa me rreth 30% të volumit të punës së personelit akademik efektiv. Manuali i MBNJ përcakton normën prej 360 orë minimale në auditor.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.18, Udhëzim i Rektorit nr.9, datë 28.07.2023 “Lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2023-2024 në “Universitetin Barleti”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar RVB dhe gjate vizitës në institucion GVJ konstatoi se UniBa për periudhën e akreditimit të programit të ciklit parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, dëshmon qëndrueshmëri të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Punësimi i stafit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Referuar dosjeve të personelit të vëna në dispozicion gjatë takimit të GVJ me Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përfshijnë jo vetëm kontratat e punësimit por edhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.6. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion që Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në UniBa paraqet qartazi procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Institucioni bazohet në dokumenta si: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe udhëzimet e rektorit për rekrutimet për të zhvilluar dhe ndjekur procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi për stafin. (Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore). Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për zbatimin e kriterëve, rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante, duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar, që garantojnë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar. (http://umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html).</p> <p>Mbështetur në procedurën e përcaktuar në Manualin e Menaxhimit të burimeve Njerëzore vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit kalon në katër faza. Faza e parë është shpallja e pozicionit të lirë të punës, faza e</p>

	<p>dytë ka vlerësimin me dosje, më pas faza e tretë që është përzgjedhja nga një komision i caktuar nga departamenti, dhe faza e katërt, i takon intervistës.</p> <p>Përsa i takon procedurës së vlerësimit, ato kanë disa nivele që nga drejtuesi i departamentit, ZMBNJ, personeli akademik, studentët dhe vetëvlerësimi që përbën përmbushjen e detyrimeve sipas pesë shtyllave kryesore; shtylla akademike, e cila përfshin të gjitha veprimtaritë e procesit të mësimdhënies, metodologjinë e përdorur shtylla e kërkimit shkencor; shtylla e studentëve dhe marrëdhënies me komunitetin; shtylla administrative dhe ajo e sipërmarrjes. https://www.umb.edu.al/mps.html.</p> <p>GVJ gjatë takimit me ZMBNJ shqyrtoi vlerësimet e dosjeve të disa anëtarëve të stafit akademik dhe konfirmon aplikimin e procedurave të vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ka lëndë të cilat janë realizuar në laboratore me kompjutera. GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion personelin ndihmës akademik për asistimin e stafit akademik në shërbim të studentëve, në funksion të përmbushjes dhe realizimit të orëve të ushtrimeve, laboratorëve që zhvillohen në City Lab apo edhe mjediseve të tjera mësimore.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme ishin të plota dhe këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij programi studimi. U verifikuan dy dosje rastësore të personelit dhe GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Për secilin person të angazhuar zyra e MBNJ mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të dosjes personale të stafit, dhe i ka ato të ruajtura në vite.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Evidenca .A.1.6.2, Formatit i Dosjes personale të stafit.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të</p>	<p>Gjatë takimeve me drejtuesit e institucionit, studentët dhe shqyrtimi i dokumentacionit u vu re se në UniBa përfshihen të gjitha grupet e interesit, duke përfshirë edhe përfaqësues të administratës publike në</p>

<p>arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>nivel qendror apo vendore, sipërmarrja e lirë, bizneset apo fondacione të shoqërisë civile, të cilat ndihmojnë në të gjitha hapat e realizimit të programit të studimit dhe ju ofrojnë studentëve praktikat profesionale. GVJ vuri re se UniBa në nivel Institucioni por edhe Departamenti kishin marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione publike, bashki dhe organizata biznesi apo sipërmarrje private brenda dhe jashtë vendit. Duhet të theksojmë se shtylla e studentëve dhe Marrëdhëniet me Komunitetin përbën një nga komponentët kryesorë edhe të vlerësimit të performancës së personelit akademik në UniBa: http://ëëë.umb.edu.al.mps.htm.</p> <p>Referenca Evidenca A.25.2, Relacion për fimitin mbi marrëveshjet e bashkëpunimit. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet “Bachelor”. Evidenca A.25.34, Tabela Përmbledhëse për RVB/ Tabela 5. Evidenca A.2.4.3, Paketa e Provës finale për Programet “Bachelor”.</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në manualin e praktikës profesionale të hartuar për, praktikat profesionale të ciklit të parë të studimeve Bachelor në UniBa, është përcaktuar në formën e një formulari kur përcaktohen edhe objektivat e personelit mbikqyrës për realizimin e praktikës profesionale. Ky personel ka detyrim vlerësimit të studentit në bazë të treguesve të përmbledhur në formular dhe asiston studentin në hartimn e raportit përfundimtar.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.25.2, Relacion mbi marrëveshjen e bashkëpunimit. Evidenca A.1.25.3, Paketa e Praktikës për Programet “Bachelor”. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/Tabela 5.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marëdhënie Ndërkombëtare”, përmbush standartet e cilësisë si për nga niveli i kualifikimit, përvoja në punë, qëndrueshmëria në këtë departament në përputhje me fushën e programit, kërkesat ligjore për garantimin e stantarteve të cilësisë dhe mësimdhënies. Bazuar në Manualin e Menaxhimit të Burimeve njerëzore rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë program studimi janë përcaktuar qartë. Departamenti bashkëpunon me institucionet që kanë marrëveshje për mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Vizita e GVJ u krye në mjediset e reja të UniBa, Kampusi 2 i cili ndodhet në Rrugën “Frang Bardhi”, Selitë dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 2,933 m2 dhe me sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 6,451 m2 . Ndërtimi i godinës së re 5 kate në Kampusin 2, sikurse dhe rikonstruktimi i godinës ekzistuese në këtë kampus, garantojnë kushte infrastrukturore bashkëkohore, të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësis, në aspektin teknik dhe didaktik, në zhvillim të veprimtarisë akademike të programit të studimit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe lëndëve përkatëse. Mjediset janë shumë të mira dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Krahas tyre UniBa ofron edhe mjedise sportive dhe mbështetëse deri tek bare e restorante. Të gjitha këto mjedise u vizituan nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Referenca Evidenca A.1.2, Organigrama e UniBa. Evidenca A.1.2.1, MAS-Dërgohet për zbatim urdhri Nr.78 “Miratimi i një ndryshimi në Statutin UniBa”. Evidenca A.1.30, Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa. Evidenca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/Tabela 16</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se sallat që përdoren gjatë procesit mësimorë ku zhvillohet programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me smartboard dhe sisteme projektimi digjitale ku stafi akademike dhe studentët konfirmuan përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies në auditoret e UniBa. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet ëi-fi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, etj., në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (Vizita në institucion). Referenca Evidenca A.1.30, Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa. Evidenca A.1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/ Tabela/16</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” nuk parashikon orë laboratorike por lëndë të tilla si “Teknologji Informacioni” përdorin laboratorë me kompjutera për realizimin e tyre. GVJ konstatoi gjatë vizitës në UniBa, se ka mjedise të</p>




<p>nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, plotësimin e kërkesave të lëndëve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të programit të studimit. Këto mjedise janë në shërbim të studentit dhe në përshtatje sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela.16.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në mjediset e UniBa, GVJ konfirmon pajisjen e mjediseve me teknologjine e nevojshme për sigurimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies maksimale. UniBa ka dy laboratorë të teknologjisë së informacionit në katin e parë, të aksesueshëm si nga stafi akademik edhe studentët, të cilët ata i përdorin gjatë lëndëve të ndryshme. GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik. Kapacitetet e UniBa dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore teorike dhe praktike mësimore.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.34. Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela.16.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion është konstatuar që UniBa ka në dispozicion të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë mjedise mësimore dhe kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit si dhe mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3 IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit për gjatë gjithë vitit akademik. Çdo fillim semestri stafi akademik bën përditësimin e literaturës në përdorim të çdo lënde në mënyrë që të garantohet marrja e njohurive të nevojshme dhe sa më bashkëkohore Literatura gjendet si në formë fizike ashtu edhe në formë digjitale në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Totali i titujve të vënë në dispozicion për studentët është 8.985 tituj dhe fondi pasurohet vazhdimisht.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën e titujve të librave për fushën e shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe administrimit publik konfirmoi që janë në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.31., Të dhëna për infrastrukturën e Bibliotekës. Evidenca A.1.31.1. Relacion mbi platformën e bibliotekës online. Evidenca A.1.31.2. Përditësimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës me tekste. Evidenca A.1.34. Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 17</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ vuri re se në çdo vit akademik Departamenti propozon një listë të përditësuar me libra për bibliotekën, që janë të përfshirë në literaturën e programit mësimor ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi bibliotekën e UniBa e cila ndodhet në katin e 1-rë të Kampusit 2 me një hapësirë 27.3 m² e cila zgjerohet me një hapësirë tjetër prej 95.1 m² në të cilën janë të arkivuara revistat dhe punimet shkencore. Në katin përdhe ka një hapësirë prej 70 m² e pajisur me 28 vende me kompjutera për aksesimin në bibliotekat dixhitale. Përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjentëve të brendshme dhe të jashtëme të saj, institucioni garanton të drejtën e çdo studenti për aksesim të bibliotekës. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit pasi e gjithë hapësira e bibliotekës ka ëi-fi. Biblioteka garanton mundësi për të gjithë me kompjutera për aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit. Studentët e UniBa kanë akses edhe në dy biblioteka online si; JSTOR dhe EBSCO. Biblioteka ishte e shfrytëzueshme njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p>Referenca Evidenca a.1.31. Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës Evidenca a.1.34. Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 17</p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, por edhe me vizitën në institucion GVJ, konstatoi se Biblioteka e UniBa është e pajisur me një fond me literaturë fizike të përditësuar, si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programit të studimit. Librat gjendeshin të pozicionuar në hapsësira të ndryshme. Një pjesë ndodhej edhe në sallën “Pit Stop” dhe në sallën e bibliotekës. Menaxhimi i librave bëhej nëpërmjet sistemit të platformës online i cili mundësonte me lehtësi menaxhimin e librave nga kategori të ndryshme dhe kontrollin e tyre. Përveç katalogut në platformë gjendeshin edhe linker për aksesimin e bibliotekave online ndërkombëtare, linke të “plagiarism Checker”, linke të “Journal Checker”: për të kontrolluar cilësinë dhe rankimin e revistave shkencore lidhur me programin e shkencave politike.</p> <p>Referenca: Evidenca. A.1.31, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës. Evidenca. A.1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 17.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UniBa u krijon kushte studentëve, sikurse edhe stafit akademik, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online si bibliotekat dixhitale EconBiz, JSTOR, EBSCO, Open Dissertation, Open Textbook Library, DOAJ, si dhe Springer Link, ku mbulohen të gjitha fushat e shkencës e teknologjisë.</p> <p>Referenca: Evidenca A1.31, Të dhëna për infrastrukturën e Bibliotekës. Evidienca A.1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/ Tabela 17.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion se biblioteka e UniBa është e pajisur me programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët e programi të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Gjithashtu, menaxhimi i librave në bibliotekë realizohet përmes Platformës digjitale të menaxhimit të librit</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion konstatoi që biblioteka e këtij institucioni operon sipas një rregulloreje dhe qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-19.45. Kërkesat për libra nga studentët dhe personeli kryen në harkun kohor 8.00-16.30. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.</p> <p>Referenca: Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe</p>	<p>Pasurimi i fondit me literaturë dhe rritja e aksesimit në bibliotekat on-</p>



<p>njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>line është politikë që ndjek UniBA. Drejtuesi i njësisë bazë DQSHPK bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e programit të studimit si dhe për rritjen e cilësisë. Gjatë vizitës në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shakallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesat apo dëmtimin e librave. Fondi digital që është në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi është tejet i pasur. Titujt e artikujve në bibliotekat online si bibliotekën dixhitale EconBiz https://ëëë.econbiz.de (rreth 200 mijë artikuj studime evropiane); JSTOR (books and journals) https://ëëë.jstor.org (rreth 180 mijë artikuj politika e BE); Ebsco Open Dissertation https://biblioboard.com/opendissertation (rreth 4.5 mijë disertacione studime evropiane); si dhe Springer https://link.springer.com (rreth 19 mijë artikuj dhe libra për politikën evropiane).</p> <p>Referenca: Evidenca A.1.31. Të dhëna për infrastrukturën e Bibliotekës. Evidenca A.1.34. Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 17.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pasi vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lendëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se ky standart është i përmbushur plotësisht. Studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Bibloteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj në përputhje me natyrën e programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesit në platformat digjitale që janë të aksesueshme pa pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB dhe vizita në institucion se UniBa ka hartuar</p>



<p>sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. Ky dokument është në funksion të menaxhimit të të dhënave, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ai përmban çështje si Portali Studentor, https://studentportal.umb.edu.al/. Sistemi e menaxhimit të të dhënave të studentëve SIS Classter, Google Classroom, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendshëm, biblioteka online, webfaqja zyrtare e UniBa (www.umb.edu.al/) dhe nënfaqet e grupit Barleti. Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin.</p> <p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon vlefshmërinë e platformës së portalit studentor LMS e Classroom që ju mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. GVJ gjatë takimit me sekretarinë mësimore konstatoi se UniBa zbaton administrimin e informacionit në mënyrë korrekte.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit UniBa. Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin e ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” menaxhohet dhe arkivohet nga zyra e sekretarisë mësimore nëpërmjet sistemit të Intranetit që mundëson komunikimin e brendshëm informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj., ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit UnBa. Vizita në institucion</p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa përmes sistemit të menaxhimit që përdor, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në internet, ashtu edhe në platformat online. Përmes sistemit G-Suit, Intranet institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përdorimi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ konsatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit, - Monitorimi i planit mësimor, - Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor, -Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual <p>Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkimin e detyrave të kursit, - Ngarkimin e projekteve, - Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik, - Marrjen e vlerësimeve, <p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafikon e provimeve - Notat e provimeve <p>Lajmërimi apo informacione të dërguara nga pedagogët apo Departamenti.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit UnBA Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit nëpërmjet personelit akademik dhe studentëve. GVJ konstatoi si nga RVB por edhe gjatë vizitës në institucion se në veçanti gjatë viteve të pandemisë Covid-19 përdorimi i platformave dhe aktiviteti mësimor u zhvillua online (në platformat google classroom), ku studentët merrnin informacionin për lëndët, modulet dhe literaturat përkatëse. Këto materiale janë të aksesueshme përmes uebafqes: https://online.umb.edu.al/ dhe kanalit në youtube të Universitetit Barleti: https://www.youtube.com/user/umb2005 përdorimi i platformave bëri të mundur rritjen e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit si për stafin dhe për studentët.</p>




<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Uniba disponon sisteme te kordinuara informacioni dhe platforma menaxhimi administrative edhe për pjesën akademike. Nëpërmjen platformës së menaxhimit të studentëve sic është Portalit Studentor, sistemi i menaxhimit akademik klasster e platforma classroom institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna në dispozicion si dhe me anë të Intranetit të monitoruar nën domainin e universitetit (umb.edu.al). Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit si më sipër, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet dhe autoritetet drejtuese. Ky përbën edhe një avantazh të UniBa të përmendur nga studentët dhe sekretaria gjatë takimeve të GVJ në institucion.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit UniBa. Vizita në institucion</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ kontrolloi informacionin e disponueshëm tek faqja zyrtare online të UniBa www.umb.edu.al/ në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe konfirmon se ajo është e pasur me informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, trajnime Barleti si dhe shërbimet e njoftimet për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të departamentit paraqesin informacion të vazhdueëshëm për studentët dhe të interesuarit.</p> <p>Referenca Raporti i Grupit të Vlerësimit të Brendshëm www.umb.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit si për studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit, ashtu për stafin akademik. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ të UniBa.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, gjithashtu në vizitën e në institucion GVJ konstaton se Raportet me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve hartohen çdo vit përmes një strukture të veçantë si Zyra për Financën. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Të ardhurat kryesore vijnë nga pagesat e studentëve të UniBa.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.28, Burimet Financiare UniBa. Evidenca A.1.28, 1 Raporti Financiar vjetor institucioni. Evidenca A. 28.2, Raporti Auditimi 2022. Evidenca A. 28.3, Plani i Financimit të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se Plani i financimit i njësisë bazë, Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, përfshihet në planin e Përgjithshëm të institucionit, i cili përmban të dhëna mbi burimet njerëzore, që zenë peshën më të madhe specifike të shpenzimeve, krahas shpenzimeve operative, për bibliotekën dhe detyrimet financiare e granteve.</p> <p>Nga Raporti Financiar Vjetor dalin qartë të dhënat mbi Strategjinë, misionin dhe objektivat e institucionit, referuar aspekteve ekonomike në funksion të realizimit të të gjitha programeve të studimit, ku përfshihet edhe ai në programin Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.28, Burimet Financiare UniBa. Evidenca A.1.28.1, Raporti Financiar vjetor institucioni. Evidenca A.28.2, Raporti Auditimi 2022 Evidenca A.28.3, Plani i Financimit të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni ka krijuar njësinë e auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Raporti i përvitshëm i Auditimit të Brendshëm ku dokumentohet situata financiare shërben që të vlerësohet efektiviteti financiar i UniBa, bazuar në balancën midis të ardhurave dhe shpenzimeve i cili i dërgohet Bordit të Administrimit të UniBa. Auditimi i Jashtëm për periudhën e akreditimit kryhet nga kompania audituese ndërkombëtare “Grant Thornton”. Raportet e auditimit të jashtëm depozitohen në faqen e Qendrës kombëtare të biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara.</p>

	Referenca Evidenca A. 28.2, Raporti Auditimi 2022.			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e RVB, Zyra e Financës së UniBa harton bilancet financiare vjetore në përputhje me aktet ligjore dhe të gjitha njësitë bazë, si dhe Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, informohen për indikatorët kryesorë. Treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit çdo vit bëhen pjesë e analizës në Bordin e Administrimit Referenca Evidenca A. 28.2. Raporti Auditimi 2022.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB-së, UniBa siguron qëndrueshmëri financiare për gjatë gjithë kohës që zhvillohet program i studimit. GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qendërzuar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucional. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit të Administrimit, rezulton se UniBa nuk ka përdorur rritjen e tarifave të studentëve si një ndërhyrje të posaçme për të rritur të ardhurat financiare. Referenca Evidenca A.1.28, Burimet Financiare UniBa. Evidenca A.1.28.1, Raporti financiar vjetor institucioni. Evidenca A. 28.2, Raporti Auditimi 2022. Evidenca A. 28.3, Plani i financimit të programeve të studimit.			
Konkluzione	<i>UniBa harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullatro në nivel universiteti dhe njesite bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Insitucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm dhe raporttet përcillen deri në njësinë bazë. Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në statutin dhe rregulloret e UniBa, si dhe informacionin e paraqitur në web zyrtarë të këtij institucioni, GVJ deklaron se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika e procedura si në nivel institucioni ashtu edhe në aktet e tjera rregullatore. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” zhvillohet në përputhje me rregulloren e vet përkatëse, në rregulloren e UniBa, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë të gjitha njësitet, rolet dhe përgjegjësit përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave të tjera të UniBa dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t’u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni, (neni 2). Rregulloret specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, regjistrimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Nga dokumentacioni dëshmohet ekzistenca dhe funksionimi strukturave të dedikuara si; Zv. Rektori për çështjet studentore i cili menaxhon zyrat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit; -Dekani i Studenteve dhe vet organizimin studentor; -Zyra e Alumnit dhe Karrierës. <p>Referenca.</p> <p>Evidenca. A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca A.1.21, Manual Rekrutimi aplikim regjistrim transferim i studentëve</p> <p>Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme për Transferimet 2023</p> <p>Evidenca A.1.23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.</p> <p>Evidenca A.1.24,6, Plani i punës zyra e Karrierës 2023-2024.</p> <p>Evidenca A.1.24,7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025.</p> <p>Evidenca A.1.24,8. Plani i punës Dekani i studentëve 2023-2024.</p> <p>Evidenca A.1.26, Rregullore për Funksionimi e Sekretarisë Mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, si dhe rregullores së institucionit, të programit të studimit por edhe evidencave të tjera shoqëruese siç është plani strategjik dëshmojnë se një ndër parimet e</p>

<p>drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>funksionimit të UniBa lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit. Procedurat e aplikimit në UniBa janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në faqen online: http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ vlerëson se të gjithë studentët ishin të kënaqur me mjedisin mbështetës në UniBa nga hyrja në dalje. Zyra e Rekrutimit, Pranimi dhe Regjistrimit të studentëve që kryen procesin E regjistrimit, respekton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë. Edhe studentët ekzistues të programit të studimit konfirmojn se procedurat janë të qarta dhe të zbatueshme për të gjithë dhe koordinatori i Departamentit (staf akademik) së bashku me stafin Administrativ të sekretarive është shumë ndihmues për ta.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca. A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca. A.1.3, rregullore e Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca A.1.21, Manuali Rekrutimi aplikim regjistrim transferim i studentëve</p> <p>Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme për Transferimet 2023</p> <p>Evidenca A.1.23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa</p> <p>Evidenca A.1.24,7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të RVB dhe pas vizitës në institucion, konstaton se UniBa harton dhe publikon cdo vit akademik kriteret të veçanta për kuotat e pranimi për çdo cikël studimesh në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit; http://umb.edu.al/pranimet.html/</p> <p>Kriteret pranimi të studentëve propozohen nga njësi bazë dhe miratohen me vendim senati. Në fillim të çdo viti akademik, shpërndarja e këtij informacioni kryhet me mjete dhe mënyra të ndryshme komunikimi. Sic janë, broshurat, fletëpalosjet, publikimet në rrjetet sociale, Web-in zyrtar të UniBa, ambientet fizike të institucionit. Këto kriteret parashikojnë dhe përfshijnë edhe kandidatë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të vecantë të komisioneve <i>ad-hoc</i>, në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit hde udhëzimeve përkatëse.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidencia,A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendeve</i></p>

	Evidenca, A, 26, rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë mësimore Evidence, A.1.30, Verifikimi I Kapaciteteve pritëse në UniBa
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konfirmoi ekzistencën e kriterëve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion, ku aksesueshmëria e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët dhe publiku. Këto kriterë dhe procedura për përzgjedhjen e studentëve në programin Bachelor janë të aksesueshme dhe të shpallura në faqen zyrtare të Universitetit. Referencat Evdienca,A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendeve</i> Evdienca,A.1.22, Rregullore e Brendshme për Transferim 2023
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë takimit me stafin dhe studentët konstatoi që në fillim të vitit akademik por edhe për gjatë gjithë tij UniBa vë në dispozicion të të interesuarve dhe publikut të dhëna në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme dhe të veçanta nëpërmjet faqes zyrtare, Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen me vendim Senati. Referencat Evdienca,A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendeve</i> Evdienca, A.1.22, Rregullore e Brendshme për Transferim 2023
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstoti se UniBa ka të hartuara dhe publikuara përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe nuk ka kriterë të veçanta për këtë program studimi. Lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, institucioni dëshmon se nuk aplikon kriterë shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it dhe mbështetje me bursa. Referencat Evdienca,A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendeve</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstaton se UniBa harton dhe publikon përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe parashikon kuota për studentët shqiptarë nga trojet si dhe për studentë nga shtete të tjera që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të udhëzimeve të MAS, pa vendosur kriterë të tjera specifike. Referencat Evdienca,A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendeve</i>

<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në kuadrin rregullator të UniBa harton politika të ndihmës ndaj studentëve në të gjitha planet, si për akomodime të atyre që vijnë nga jashtë Tiranës, edhe ndihma financiare për ata në nevojë. Institucioni në mbështetje të kriterëve specifike të parashikuara në aktet e tij ofron bursa studimi dhe i bënë ato publike. Administratori krijon komisionin Ad-Hoc për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimi bëhet me vendim të Bordit të Administrimit të UniBa.</p> <p>Referencat Evidenca, A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 54,</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Këto procedura janë lehtësisht të kuptueshme, të aksesueshme në faqen online dhe janë zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion por edhe nga faqja zyrtare e web të UniBa, GVJ vlerëson se ky institucion ju kushton vëmendje të veçantë marrëdhënies me studentët. Nëpërmjet Koordinatorës së Departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët marrin informacion të plotë dhe me detaje lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre siç janë vlerësimet për lëndët gjatë gjithë vitit akademik, sikurse dhe frekuentimi me 50% të orëve në leksione dhe 75% të orëve në seminare. Rregulloret e Universitetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin që kryhet në UniBa.</p> <p>Kalimi në vitin pasardhës bëhet nëse studenti ka grumbulluar 50% të krediteve (neni 7 i rregullores së programit të studimit). Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit të studentëve dhe sekretaritë mësimore u bëjnë me dije studentëve të gjitha evidencat mbi rezultatet e tyre akademike sipas krediteve të formalizuara në Ligjin 80/2015.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti</p>

	Evidenca A.2.4, Rregullore e Programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion GVj konstaton se në UniBa studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Kriteret e procedurat e njohjes se krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit për transferimet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një studentë që transferohet, në një program studimi të Fakultetit, merret nga komisiioni ad hoc përkatës i ngritur nga njësia bazë pranuese.</p> <p>Referenca Evidenca, A.1.21, <i>Manual Rekrutimi Aplikim Regjistrim Transferim e Studendëve</i></p> <p>Evidenca A.2.4, Rregullore e Programit të studimit.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>GVj konstatoi nga takimi me studentët se UniBa i informon studentët në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Rregulloren e programit të <i>të studimeve</i> Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marërdhënie Ndërkombëtare”. Në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar kriteret forma dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve. Studentët informuan GVj se në cdo javë të parë të semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke njohur syllabusin e lëndës.</p> <p>Krahas njohjes me Rregulloren, kontakteve me koordinatoren e programit dhe sekretaritë, studentët informohen nga çdo pedagog në orën e parë të lëndës, ku prezantohet programi dhe ju bëhen të qarta studentëve format e vlerësimit të dijeve, aftësive e kompetencave (verifikimi i syllabuseve ku përcaktohen këto komponentë në mënyrë të unifikuar sipas kuadrit rregullator). Po ashtu, në Rregulloren akademike të UniBa, përcaktohen format e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve.</p> <p>Referenca Evidenca A.2.4, Rregullore e Programit të studimit.</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi se institucioni nëpërmjet strukturave përkatëse kryente informimin lidhur me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të këtij programi studimi.</p> <p>Kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit në kreun IV të saj si dhe në Paketën e provës finale. Institucioni UniBa ka hartuar një udhëzues në formën e rregullore “Udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe të</p>

	<p>mbrojtjes së provës finale për diplomën e studimeve Bachelor”. Studentët njihen me këtë dokument në fillim të semestrit të dytë nga koordinatori i studimeve master të UniBA. Në rubrikën 2.4 të këtij dokumenti “Përgjegjësit e Studentit”, pika a. shprehet “Studenti duhet të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të provës finale”</p> <p>Referenca Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.2.4, Rregullore e Programit të studimit. Evidenca A.2.4. Plani mësimor i programit të studimit</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB, gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare ne UniBa GVJ konstatoi se cdo fillim viti akademik , Departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera Brenda institucionit zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit. Gjatë takimit me stafin GVJ konfirmoi se në UniBa Publikon një udhëzues Mbështetur në Strategjinë e Marketingut dhe të Rekrutimit ku planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Në çdo fillim të vitit akademik UniBa zhvillon “Javën e orientimit” për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.24.1, Rregullore e Zyrës Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës Evidenca A.1.24.6 ,Plani i Punës Zyra e Karrierës 2023-2024 Evidenca A.1.24.7, Plani strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025 Evidenca A.1.34. Tabelat Përmbledhëse për RVB/ Tabela 23</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit programit të studimeve Bachelor në “ Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. GVJ shpreh vlerësimin se standarti përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, por edhe informacionin e marrë nga takimet në institucion, GVJ konkludon se UniBa e ka praktikë pozitive faktin që në fillim të vitit akademik informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të <i>të studimeve</i> Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p> <p>Ngritja e strukturës Dekani i Studentit është një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentin për ta përfshirë jo vetëm në qasjet sociale të Institucionit por edhe për informimin e tyre, për çdo nevojë që paraqesin studentët. Po ashtu, me fillimin e programit mësimor, pedagogu Koordinator i Departamentit orienton studentët për të gjithë komponentët që kanë lidhje me organizimin e programit të studimit. Fletëpalosjet në mjediset hyrëse të UniBa dhe të dhënat e detajuara në faqen e internetit të UniBa sigurojnë informimin e plotë për programin të <i>të studimeve</i> Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgaditura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit, dokumentacionin për lëndët, modulet dhe veprimtaritë formuese. Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi lëndor ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar si dhe format e vlerësimit të dijeve.</p> <p>GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin e zhvilluar me studentët e programit të <i>studimeve</i> Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p> <p>Referenca</p> <p>Evidenca A.1.25, Udhëzuesi për metodat e mësimdhënies</p> <p>Evidenca A,1,26, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie</p> <p>Evidenca, A2, 4.1, Plani mësimor i programit të studimit</p> <p>Evidenca, A,1.34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/Tabela.14</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se UniBa ka lidhur marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese dhe kanë krijuar një rrjet bashkëpunëtorësh dhe partnerësh për të mbështetur studentët e tyre për të kryer praktikat profesionale të cilat janë orientuese për tregun e punës (Tregu i punës, çelësi i një karriere të sukseshme: https://www.umb.edu.al/neës4856.html/. Gjatë takimit me përfaqësues të zyrës së Alumnit dhe Karrierës GVJ u njoh me aktivitete dhe trajnime që organizohen në kuadër të orientimit të studentëve drejt tregut të punës</p>

	<p>https://www.umb.edu.al/nees1140.html/. Dokumentacioni shoqërues dëshmon se nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UniBa ka me institucionet publike dhe sipërmarrjet private studentët mund të përfitojnë mbështetje për punësim dhe zhvillim karriere.</p> <p>Referenca Evidenca, A.1. 25, 2, Relacion përfitimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit Evidenca A1.34, Tabelat Përmbledhëse RVB/Tabela 5 Evidenca A1. 24.1, Rregullore e zyrave studentore dhe e këshillimit të karrierës Evidenca A1, 24.6, Plani i Punës Zyra e Karrierës 2023-2024 Evidenca, A1, 24.7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025 Evidenca, A1, 24.8, Plani i Punës Dekani i Studentëve 2023-2024 Evidenca, A,2.6, Studimi i Tregut të Punës Evidenca, A,2.7, Nngritja e Bordit të Karrierës në Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga RVB dhe në vizitën e zhvilluar në institucion GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore , Zyra e Karrierës dhe Alumnit, si dhe pedagogët e Departamentit të Qeverisjes Shkencave Politike dhe Komunikimit luajnë rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me të gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik. Informacioni i përditësuar vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të zyrave të informimit apo Karrierës dhe Alumnit në website-in zyrtar të UniBa. www.umb.edu.al/</p> <p>Referenca Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstatoi se nëpërmjet faqes web zyrtare të UniBa, www.umb.edu.al/ studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën shërbimet dhe aktivitete të tjera që zhvillohen nga universiteti. GVJ pas vizitës në institucion konfirmon se sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit është funksional dhe realizon në kohë reale informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. i cili publikohet në faqen online të UniBa dhe u nisat me e-mailin personal studentëve. Gjithashtu vlerësimet e testeve, provimeve dhe detyrave studentët mund t'i gjejnë në portalin studentor: http://studentportal.umb.edu.al/.</p> <p>Referenca Vizita në institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentëve të programit të studimit bachelor në "Shkenca Politike"</i></p>




	<p>me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare", u vihet në dispozicion informacion i plotë dhe i hollësishëm për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Institucioni, departamenti dhe zyra e Karrierës dhe Alumnit kanë në fokus të punës nxitjen e bashkëpunimeve dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, gjithashtu kujdesen për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe hapësirat që ka në tregun e punës për këtë nivel kualifikimi dhe program studimi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UniBa mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuarve, në programin bachelor "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare". Programi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2021-2022 ku kishte të regjistruar 3 student. Programi është për herë të parë në proces akreditimi dhe një nga sfidat e tij ka qënë numri tejet i vogël i studentëve të regjistruar (1 stud për VA.2022-2023 dhe 0 stud për VA 2023-2024). GVJ pa nga afër përgjatë takimit me përfaqësues të sekretarisë mësimore dokumentacionin respektiv. Gjithashtu dhe nga takimi me përfaqësues të zyrës së Alumnit dhe Karrierës u informua se vetëm një student është i punësuar dhe ai jo brenda profilit të studimit. Institucioni ka dhe disponon të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar çdo vit akademik në këtë program.</p> <p>Referenca Evidenca A,1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 21, Tabela 23.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo</p>	<p>GVJ konfirmon se Sekretaria Mësimore e UniBa mban në mënyrë të rregullt të gjithë regjistrat e duhur si: regjistrat themeltar, të arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave, të cilat janë formatuar dhe përditësuar sipas standarteve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgaditur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve, procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Krahas tyre jepet edhe një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të</p>

<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>parë Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë ç’regjistruar.</p> <p>Referenca Evidenca A,1.26, Rregullore për Funksonimin e Sekretarisë Mësimore. Evidenca, A,1.34, Tabelat përmbledhëse për RVB/Tabela 21, Tabela 23.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se institucioni ka një sistem të brendshëm elektronik të menaxhimit të të dhënave. Sekretaria Mësimore kujdeset për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, proceverbalet e provimeve, dosjet personale të studentëve) depozitimi i të dhënave për secilin student afza e regjistrimit deri në diplomim, janë të regjistruara, sipas formateve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ashtu edhe në formë elektronike, që menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Të dyja mënyrat e ruajtjes e lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si dhe japin siguri lirdhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.</p> <p>Referenca RVB- Bachelor në Shkenca politike me profile Evidenca A, 1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A,1.26, Rregullore për Funksonimin e Sekretarisë mësimore</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UniBa është strukturë ndihmëse akademike me karakter administrativ, e cila zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, konstatoi se UniBa analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje si dhe harton raporte vjetore duke saktësuar, dokumentuar dhe vlerësuar gjendjen dhe saktësinë e informacionit por edhe të dokumentacionit që lidhet me studentët për realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Përdorimi i sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe portalit studentor, ku gjenden të dhënat mbi rezultatet akademike të studentëve, kalueshmërinë sipas lëndëve si dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta, pasi përpunohen nga sekretaria mësimore, kalojnë për shqyrtim tek drejtuesit e institucionit.</p> <p>Referenca RVB- Bachelor në Shkenca Politike me profile Evidenca A, 1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A,1.26, Rregullore për Funksonimin e Sekretarisë</p>



	mësimore			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe vizita në institucionin, GVJ konstatoi se Departamenti realizon analizën vjetore mbi organizimin e programeve të studimit që janë pjesë e tij. Analiza vjetore tregon të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve bazuar në statistika duke dhënë informacion dhe për profilin dhe cilësinë e studentëve, si dhe rezultatet e arritura prej tyre deri në diplomim. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit dhe Karrierës bashkëpunojnë për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancën në sistemin universitar, si dhe lehtësimin në procesin e rekrutimit nga punëdhënësit. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p>Referenca RVB- Bachelor në Shkenca politike me profile Evidenca A. 2.5, Analizë vjetore e Punës së Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit (viti akademik 2022-2023) Evidenca A.1, 14, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023</p>			
Konkluzione	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se UniBa disponon statistika vjetore mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre në programin e studimit ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore	Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores dhe Statutit të UniBA, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjinale dhe vendimmarrëse sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese bëhet sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të institucionit.

<p>dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UniBa ka mundësuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanceve të Barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë. Ata janë anëtarë më të drejtë vote njësojë si personeli akademik. Institucioni ka një rregullore dedikuar Qeverisë Studentore ku vendosen parimet e politikës të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative të tyre. Gjithashtu në mbledhjet e Departamentit që organizohen një herë në muaj janë të hapura edhe për studentët.</p> <p>Referenca Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A.1,3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A.1, 9.1, Vendim Nr.46, Datë 24.11.2023 “Për Miratimin e Përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa Evidenca A.1, 23, Rregullore e Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve pranë UniBa Evidenca A.1, 24, Politika e Mbështetjes përkrahjes për Studentët dhe Struktura e Organizative të tyre Evidenca A.1, 24,1, Rregullore e Zyrave Studentore dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca A.1, 24,2, Rregullore e Qeverisë studentore Evidenca A.1, 24, 5, Të dhënat për Këshillat studentore dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se në Statutin e UniBa dhe Rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur, po ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në mënyrë periodike për mësimdhënien, që realizohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përcillen në Departament dhe Dekanat si dhe vetë pedagogëve për të reflektuar në procesin e mësimdhënies. Formulari i vlerësimit të studentëve që iu vu në dispozicion GVJ gjatë takimit në institucion përmbante 5 komponentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimin e Lëndës; 2. Përmbajtja e Lëndës; 3. Materialet e Lëndës; 4. Komponentët e vlerësimit; 5. Pedagogu, për të cilat studentët japin gjykimet e tyre anonime si dhe shqyrtoi raportet e vlerësimit të studentëve. <p>Referenca Evidenca A.1.10, Rregullore E NJZHKC-së Evidenca A.1.10.2, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën</p>

	<p>Evidenca A.1.10.3, Raport i Vlerësimit të Studentëve , V.A. 2022-2023</p> <p>Evidenca A.1, 13, Raport Vjetor për Vlersimin e Cilësisë në UniBa</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me përfaqësuesit e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë si dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, vlerëson përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta. Rezultatet e pyetësorëve komunikohen me e-mail pedagogëve individualisht dhe përdoren si nga pedagogët, Departamenti dhe strukturat e tjera për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies. Në këtë mënyre, UniBa garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit që realizohet përmes pyetësorëve me fokus grupe të studentëve.</p> <p>Referenca</p> <p>Evidenca A.1.10, Rregullore E NJZHKC-së</p> <p>Evidenca A.1.10.2, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën</p> <p>Evidenca A.1.10.3, Raport i Vlerësimit të Studentëve , V.A. 2022-2023</p> <p>Evidenca A.1, 13, Raport Vjetor për Vlersimin e Cilësisë në UniBa</p> <p>Evidenca A.1.14. Raport Vjetor UniBa 2022-2023</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UniBa, GVJ konstatoi se në çdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve ma anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve është pjesë përbërëse e syllabusit në çdo lëndë dhe ofron shpërndarjen e pikëve dhe të përqindjeve të vlerësimit sipas rubrikave përkatëse. Që në fillim studenti e di se testimi final është 50% e vlerësimit, frekuentimi është 10%, detyra e kursit 20% dhe testet gjatë vitit janë 20%. Nga verifikimi i syllabuseve rezulton që formatet e tyre janë të unifikuara dhe format e kontrollit të dijeve të diversifikuara. Studenëve ju lihet kohë për argumentimin nga pedagogu i lëndës i vlerësimit, nëse kanë pakënaqësi për vlerësimin. Zhvillimi i seancave sqaruese dhe rishikimi i vlerësimit janë tregues i vëmendjes së institucionit ndaj transparencës me studentët gjatë procesit të vlerësimit.</p> <p>Referenca</p> <p>Evidenca A,1.3, Rregullore e UniBa, Nenet 88, 90</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBA i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet pyetësorëve të lëndës ashtu edhe procesit të ankimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e</i></p>

	<p>studentëve me fokus-grupe tematike. Kjo realizohet falë përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, që veprojnë në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit. GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, si në Senatën Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanceve të Barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë. Institucioni ka një rregullore dedikuar Qeverisë Studentore në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në programin e studimit ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UniBa ka krijuar të gjitha strukturat dhe procedurat dhe njësi të posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës dhe Koordinatorin e Departamentit që janë funksione administrative të strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UniBa, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin. Institucioni organizon në fillim të vitit akademik "Javën e orientimit" gjatë së cilës personeli akademik i departamentit ju prezanton studentëve programin dhe i njeh ata me syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Referenca Evidenca A,1,3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A,1, 24, Politika e mbështjetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura e organizmit të tyre Evidenca A,1, 24,1, Rregullore e zyrave studentore dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca A,1, 26, Rregullore për Funksimin e Sekretarisë Mësimore</p>

	Evidenca A,1, 24,3, Strategjia e Klubeve Studentore 2020-2025 Evidenca A,2.4, Rregullore e programit të studimit
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se struktura si Sekretaria Mësimore në bashkëpunim me njesinë bazë që ka në stukurën e saj një koordinator për çështjet e mbarëvajtjes së procesit mësimor, ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet e studentëve dhe departamentit dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua nga studentët se ata marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë UniBa-s, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. Madje një ndër arsyt pse studentët parapëlqyen të studionin në UniBa ishte edhe gatishmëria e stafit mbështetës për të plotësuar nevojat e tyre studentore. Referenca Evidenca A,1, 24,1. Rregullore e Zyrave Studentore dhe Këshillimit të Karrierës Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, GVJ konstatoi se UniBa ofron shërbimin e këshillimit për karrierën për studentët dhe në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Zyra e Alumnit dhe Karrierës si dhe Klubi i Karrierës. (http://umb.edu.al/neës1283.html/). Gjatë vizitës në institucion dhe takimet me me përfaqësues të kësaj njësie dhe me studentët e programit GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj zyre në bashkëpunim me struktura/zyra të tjera të UNIBa fokusohet në informimin e vazhdueshëm të studentëve për organizmin e trajnimeve apo edhe orientimin për realizimin e praktikave profesionale si dhe ofron informime në lidhje me mundësitë e punësimit të tyre. Krahas kësaj në UniBa është ngritur edhe Klubi i Karrierës i cili përbën një ndër klubet studentore që organizon studentët dhe zhvillon me to aktivitete lidhur me zhvillimin e karrierës duke synuar përmirësimin e aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për të rritur konkurrencën dhe ofertë kërkesën e tyre në tregun e punës. Referenca Evidenca A,1,3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A,1,24,Politika e mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura e organizmit të tyre Evidenca A,1, 24,1, Rregullore e Zyrave Studentore dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca A,1, 24, 6, Plani i Punës Zyra e Karrierës 2023-2024 Evidenca A,1, 24, 7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025 Evidenca A,1, 34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/ Tabela 23
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas	GVJ konstatoi se Zyra e Alumnit dhe Karrierës në UniBa ndjek studentët e diplomuar, komunikon me ta dhe ka siguruar një databazë

<p>diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>në lidhje me punësimin e tyre. Studentët e diplomuar ruajnë e-mailin e UniBa edhe një vit pas diplomimit, kjo i shërben institucionit për të ruajtur dhe vazhduar komunikimet me ta. Zyra e Alumnit dhe Karrierës zhvillon edhe sondazhe me studentët e diplomuar konform rregullave të UniBa, në lidhje me gjurmimin e studentëve të diplomuar përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i pasqyron rezultatet në raporte vjetore që ju vihen në dispozicion të gjitha strukturave të UniBa, që nga njësia bazë derit tek autoritet drejtuese.</p> <p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës i mbledh studentët e diplomuar në aktivitete ku ata ndajnë përvojat e tyre dhe informacione për tregun e punës (Barleti Alumni Reunion: https://www.umb.edu.al/news4899.html)</p> <p>Referenca Evidenca A,1,24,Politika e mbështjetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura e organizmit të tyre Evidenca A,1, 24,1, Rregullore e Zyrave Studentore dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca A,1, 24, 6, Plani i Punës Zyra e Karrierës 2023-2024 Evidenca A,1, 24, 7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025 Evidenca A,1, 34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/ Tabela 23</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët e programin e studimit ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përbushjes së standardevë të fushës V</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht X</p>
---	----------------------	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në vizitën në Institucion dhe takimet e organizuara, GVJ konstatoi se, UniBa angazhohet për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe se vetë institucioni ka hartuar udhëzues dhe manuale për mësimdhënien dhe të nxënit në shkollat e larta. Stafit akademik janë shpesh pjesë e trajnimeve dhe takimeve orientuese mbi metodat inovative. Studentët konfirmuan që nga koha e pandemisë e në vazhdimësi ata përdornin platforma si Google Classroom bazuar në manualin e mësimdhënies online apo përdorin metoda inovative siç janë “Udhëzuesi për përdorimin e Strukturës të Teknologjisë dhe Informacionit” në Uniba.</p> <p>Referenca</p> <p>Evidenca A,1,9, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të cilësisë</p> <p>Evidenca A,1,9,1, Vendim Nr.46, datë 24.11.2023 “Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë” në UniBa</p> <p>Evidenca A,1,10, Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë</p> <p>Evidenca A,1, 15, Udhëzues për metodat e mësimdhënies</p> <p>Evidenca A,1,29, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së Infomacioneve në UniBa</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UniBa nëpërmjet NJZHKC dhe Zv. Rektori për çështjet mësimore, Zyra e Vlerësimit të performancës të cilët janë strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor vlerësojnë në mënyrë periodike mësimdhënien, aplikimin e të rejave në metodat e mësimdhënies si nga ana e personelit akademik ashtu edhe për personelin ndihmës akademik me qëllim koordinimin e veprimtarisë së sigurimit të cilësisë sipas programeve të studimit. Gjithashtu GVJ konstatoi se referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, UniBa praktikon disa mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive të mësimdhënies të pëersonelit akademik. Mekanizmat e monitorit arrihen nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimit që studentët bëjnë në përfundim të çdo semestri lidhur me performancën e personelit akademik në mësimdhënies; 2. Vlerësimit <i>peer to peer</i> midis kolegëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies; 3. Nëpërmjet analizave dhe rrahjes së mendimeve në njësinë bazë; <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.1,7, Rregullore për Vlerësimin dhe Adminstrimin e Performancës</p> <p>Evidenca A.1,8, Format i raportimit të punës semestrale</p> <p>Evidenca A,1,10.1, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching)</p>

	<p>Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</p> <p>Evidenca A,1,17, Formulari për transparencë të vlerësimit të studentëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se të dhënat e paraqitura nga UniBa tregojnë që përfshirja e studentëve në vlerësimin e formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve kryhet në mënyrë periodike dhe në mënyrë të vazhdueshme. Nga takimi që GVJ pati me studentët u konfirmua që ky proces kryhej dy herë në vit në përfundim të çdo semestri duhet të jepnin vlerësimin e dijeve, duke argumentuar cilësitë pozitive dhe mundësitë për përmirësimin e leëndës. Ata dëshmuuan se nuk kanë patur raste ankimimesh dhe se disponibiliteti i strukturave përgjegjëse nuk i'u kishte munguar.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A,1,3, Rregullore e Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</p> <p>Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra Njësia e Zhvillimit Kurrrikular dhe Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë referuar rregullores së saj raportojnë mbi vlerësimet e mbledhura në fillim tek personeli akademik e më pas në instancat drejtuese të institucionit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe shërbejnë si pjesë e diskutimeve brenda departamenteve duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Përmbledhja e raportit vjetor nëhet publike në faqen zyrtare të institucionit në linkun http://umb.edu.al/dossier-uniba.html/.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, gjithashtu edhe nga takimet me stafin dhe përfaqësues të NJZHKC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimit të personelit të cilat promovojnë praktikat më të mira nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Gjithashtu institucioni nëpërmjet mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm në disa nivele promovon shembuj të praktikave të mira përsa i takon metodave të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, punës kërkimore etj. GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e stafit akademik përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p> <p>Evidenca A.25,1, Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të Erasmus +</p> <p>Evidenca A.1,33, Promovim i shembuj të praktikave të mira</p>

Konkluzione	<i>Kuadri rregullator i UniBa u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. UniBa ka politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në dokumentacionin e RVB dhe nga vizita në institucion GJV konstatoi se, në planin strategjik 2020-2030 të zhvillimit të UniBa, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit janë të përcaktuara, bazuar në analizën Sëot të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, një vëmendje e vecantë i kushtohet procedurave për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. UniBa harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi https://www.umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html/.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A,1,9, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të cilësisë</p> <p>Evidenca A,1,9,1, Vendim Nr.46, datë 24.11.2023 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë" në UniBa</p> <p>Evidenca A,1,10, Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë</p> <p>Evidenca A,1,1, Statuti i Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca A,1,3, Rregullore e Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca A,1,7, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin	Bazuar në dokumentacionin e RVB dhe nga vizita në institucion GJV konstatoi UniBa ka ngritur njësinë e zhvillimit të Kurikulës dhe cilësisë (NJZHKC) e cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJZHKC ka akses në të gjitha të dhënat e UniBa, dhe realizon politikat, strategjitë institucionale dhe proceset për të garantuar cilësinë në UniBA. Gjithashtu komisioni i

<p>e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>sigurimit të cilësisë jep sugjerimin dhe rekomandonte në funksion të përmirësimit të cilësisë në institucion. Në Statutin e UniBa, neni 10, 28, në Rregulloren e UniBa, neni 14, 15, në aktet e tyre rregullatore, dhe në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë përcaktohen dhe zbatohen proceset themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e kurrikulave, mbështetur në kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe në vendimet e udhëzimet e strukturave drejtuese të institucionit.</p> <p>Referencat Evidenca A,1,4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030 Evidenca A,1,23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa Evidenca A,1,25,2, Relacion Përfitimi mbi marrëveshjen e bashkëpunimit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se Instrumenti që përdor UniBa për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. GVJ gjithashtu konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UniBa realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare në fund të vitit 2021. NJZHKC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies mblidhen të dhëna nga stafi akademik nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët nga të diplomuarit nga stafi administrativ dhe mbi bazën e analizave krahasuese të tyre gjykohet për përmirësim të proceseve që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit.</p> <p>Referencat Evidenca A,1,10.1, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching) Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023 Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën Evidenca A, 1, 17, Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e RVB , GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualin e UniBa, paraqet qartë politikat e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Institucioni dëshmon se si tregues të matshëm për</p>




<p>dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>mësimdhënie dhe kërkim-shkencor përdor vetëdeklarimin që personeli akademik bënë në përfundim të çdo semestri dhe nëpërmjet vlerësimit që drejtuesi i njësisë bazë i bënë punës së çdo personeli akademik, anëtari të njësisë e cila është një procedurë e standartizuar në institucionet e arsimit të lartë në vend. Duke mbajtur në konsiderat që kjo formë është vetëdeklaruese dhe nuk përmban tregues të detajuar për vlerësimin e procesit mësimor GVJ sugjeron hartimin e një kuadri vlerësues me tregues konkret të pikëzuar sipas rëndësisë dhe peshës që ato duhet të kenë për këtë vlerësim. Kjo mënyrë do të mundësojë evidentimin e praktikave më të mira në mësimdhënie nga personeli akademik dhe promovimin e personelit akademik me arritje në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p>Referencat Evidenca A,1,6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Evidenca A,1,7, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës Evidenca A, 1.8, Format i raportimit të punës semestrale Evidenca A, 1, 14, Raport Vjetor UniBa 2022-2023</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka politika dhe procedura transparente në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se NJZHKC raporton në nivel institucional mbi procese të ndryshme monitorimi. Raporti i përgaditur i ofron të dhëna të rëndësishme mbi një sërë treguesish të performancës siç është rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore në nivel institucional, mbikëqyrja dhe rishikimi i programit të studimit nga sektori i kurrikulës Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Departamenti janë strukturat kryesore që bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e rishikimin e këtij programi. UniBa përmes NJZHKC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti.</p>



<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit. NJZHKC nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, zbulon problematikat nqs ka të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato pranë departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJZHKC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, NJZHKC mbikqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve. Raportet e realizuara nga NJZHKC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit akademik. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati ku Zv. Rektori për çështjet akademike organizon dhe mbikëqyr punën e fakulteteve dhe programeve me qëllim rritjen e standarteve të cilësisë, në programet e studimit të ofruara nga UniBa dhe mësimdhënies nga ana e personelit akademik, njëkohësisht merret me shqyrtimin e fushave problematike marrjen e vendimeve dhe zhvillimet e ardhshme.</p> <p>Referencat</p> <p>Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023</p> <p>Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p> <p>Evidenca A,2.5, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit (viti akademik 2022-2023)</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dhe informacionit të marrë nga vizita në institucion, rezulton se NjZHKC organizon monitorimin e procesit të përmbushjes së masave në kuadër të gjetjeve të konstatuara nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dheme anë të anketave dhe pyetësorëve. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse.</p> <p>Ndërkohë në nivel institucioni NJZHKC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe stafi. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbedhja e të dhënave realizohet nga kjo zyrë e cila së bashku Zv Rektorin për çështjet akademike ja paraqesin rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. Problematikat që hasen brenda programit të studimit shoqërohen me rekomandime dhe plan masash për trajtimin e mangësive dhe përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p>Referenca</p>




	<p>Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023</p> <p>Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB dhe vizita në institucion se UniBa për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare.përdor metoda të drejtpërdrejta sikurse janë raportimet në nivel departamenti, vlerësimet periodike të procesit mësimor të kryera nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë si dhe monitorime në nivel institucional nga Zv. Rektori për Çështjet Akadematike. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore te punës së tij, ku krahas mendimeve te pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët. Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejta për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik -Vet raportimi i personelit akademik për punën semestrale; - Mbledhje periodike e njësisë bazë që ka përgjegjësinë për programin dhe ka për objekt ecurinë e procesit mësimor; - Vlerësimi paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i njësisë bazë; - Raporti vjetor i njësisë bazë ku analizohen arritjet dhe mangësitë e procesit mësimor; <p>Referenca</p> <p>Evidenca A,1.8, Format i raportimit të punës semestrale</p> <p>Evidenca A,1,10.1, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching)</p> <p>Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</p> <p>Evidenca A,1,17, Formulari për transparencë të vlerësimit të studentëve</p> <p>Evidenca A,2,8, Vendim Rektorati Nr.94 dt.12.02.2021 “ Për miratimin e formatit të provimeve, etj.,”</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i RVB se në rregulloret e institucionit apo në rregulloren për funksionim dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë janë të përfshira metoda të tërthorta të vlerësimit të procesit mësimor dhe shërbejnë në përmirësimin e tij. Gjithashtu institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejta për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Formular vlerësimi i studentëve për lëndën; - Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë; <p>Informacioni i synuar lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e lëndës; - Programin e lëndës;

<p>institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Materialet e lëndës; - Komponentët e vlerësimit; - Materialet e mësimdhënies; - Performanca e klasës; - Vëzhgime; <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi realizimin e tyre si nga studentët ashtu edhe nga takimi me personelin akademik që shërben në programin e studimit.</p> <p>Referenca Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UniBa parashikon mekanizma formal për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi Në nivel Institucional NJZHKC përgadit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasiorë dhe monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrëperiodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet përmes metodave të drejtpërdrejta, dhe jo të drejtpërdrejta. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet studentëve për lëndët, evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jpen rekomandime për përmirësimin e situatës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësiti akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në në informacionin e Paraqitur në RVB Rregulloren e UniBa, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. UniBa realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si programi Erasmus +. Nga shqyrtimi i Rregullores së Standarteve dhe Cilësisë përcaktohet se 4 prej anëtarëve të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë janë përfaqësues</p>



	<p>të personelit akademik, përfshirë edhe përfaqësues të personelit akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë ekspertë të fushës në institucione të ndryshme publike dhe OSHC, si Bashkinë e Tiranës, etj.</p> <p>Referencat Evidenca A,1.4, Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030 Evidenca A.2.3.2, Plani Strategjik për Zhvillimin e DQSHK Evidenca A,1.9, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë Evidenca A,1, 24,1, Rregullore e Zyrave Studentore dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca A,1, 24, 7, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025 Evidenca A,1,25.2, Relacion Përfitimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit Evidenca A,1, 34, Tabelat Përmbledhëse për RVB/ Tabela 5</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur dhe nga vizita në GVJ konfirmoi se në Rregulloren e UniBa, përcaktohet organizmi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në Rregulloren e UniBa, Rregulloren e Komisionit dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe planet e punës të këtyre Njësive.</p> <p>Referencat Evidenca A,1.3, Rregullore e Universitetit Barleti Evidenca A,1.9, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë Evidenca A,1.9.1, Vendim Nr.46, datë 24.11.2023 “Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë” në UniBa Evidenca A,1,10, Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë Evidenca A,1,11, Manuali i Cilësisë Evidenca A,1,12, Plani i Punës së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>GVJ kjonstatoi se në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programin të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare” garantohet përfshirja e personelit akademik nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, stafit ndihmës administrative dhe studentët – 1 përfaqësues i të cilëve ishte në GVB. Metodologjia dhe procesi i hartimit të RVB e përshkruar në hyrje të raportit dhe e konfirmuar nga biseda me grupin</p>



administrative dhe studentëve e programit të studimit.	e vlerësimit të brendshëm tregon përfshirjen e përfaqësuesve nga Departamenti, anëtarë të personelit akademik, nga personeli administrativ dhe një student i këtij programi studimi. Referencat Evidenca A.2.1,1, Urdhër i Rektorit të UniBa, nr, 52, datë 18/04/2024 “Për ngritjen e GVB-së”
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vlerëson se UniBa ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit të njëjësive respektive si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rrotacioni...etj. Institucioni ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit . GVJ nga takimet me stafin akademik dhe zyrat respektive që merren me vlerësimet konfirmoi se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhej në mënyre individuale për çdo personel akademik dhe problematikat në përgjithësi diskutoheshin në mbledhjet e Departamentit për të marrë vendime unanime. Referencat Evidenca, A1, 1, Statuti i Universitetit Barleti Evidenca A1, 5, Kodi I Etikës UniBa
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UNiBa angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Mendimet dhe ekspertiza e tyre shtrëtohet për përmirësimin e vijueshëm të programit të studimit dhe vjen nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e departamentit, aktiviteteve të përbashkëta, si projekte, konferenca, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me institucione publike dhe private etj. Referencat Evidenca A1, 25,2 Relacion Përfitimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit Evidenca A2,7, Ngritja e Bordit të Karrierës në Departamentin e Qeverisjes Shkecnave Politike dhe Komunikimit
Konkluzione	<i>Kuadri rregullator i UniBa përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. UniBa ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset e vlerësimit. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyrojnë aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët, vlerëson se UniBa realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit</i>





	<i>të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB si dhe gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UniBa parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtarisë në kuadër të sigurimit të cilësisë. UniBa ka në faqen e saj zyrtare informacionin e kërkuar, si kusht kryesor i transparencës për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohen në kohë reale në faqen online: https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html/ dhe të zyrës së performancës: https://www.umb.edu.al/mps.html/.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimet në faqen zyrtare web të UniBa dhe raportet e analizave të zhvilluara repsektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me rregulloren e institucionit, ndërsa studentët dhe stafi akademik informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare web të UniBa dhe komunikimeve në sistemin e brendshëm online Sis Cluster apo portalin studentor. Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në nenin 2 të saj përmban parimet mbi të cilën bazohet sigurimi i brendshëm i cilësisë. Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e web site-it të UniBa dhe në seksionin e Vlerësimit të performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre.</p> <p>Referencat Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>

<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik raportet e NJZHKC-së përcillen në njësinë bazë të programit studimit. Struktura të universitetit me Urdhër të Rektorit vihen në lëvizje për adresimin hapave që lidhen me përmirësimin e mangësive. Nga shqyrtimi i evidencave disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor.</p> <p>Referencat Evidenca A,1,10, 2, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023 Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional.</p> <p>Analizat e zhvilluara në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet apo përmirësimet e nevojshme. Referuar planit strategjik të UniBa vlerësohet efektiviteti dhe impakti që kanë veprimtaritë në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimin në vijim.</p> <p>Referencat Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJZHKC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional.</p> <p>Referencat Evidenca A,1,10, 3, Raporti i Vlerësimit të studentëve V.A. 2022-2023 Evidenca A.13, Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së UniBa</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBa publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjitha palëve të interesuara. Të gjitha materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë akademike si dhe legjislacionin në fuqi. Në të gjitha raportet e analizës së zyrave dhe në nivel departamenti, fakulteti, universiteti janë përfshirë tregues të matshëm për vlerësimin sa më efektiv të aktiviteteve të zhvilluara për monitorimin dhe sigurimin e përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë bachelor në “Shkenca Politike” me profile Administrim Publik dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti ka një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator që mundëson realizimin e procesit mësimor, kërkimor e shkencor dhe një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi;
2. UniBa ka dhe përdor platforma digjitale që i vinë në ndihmë studentëve, duke mundësuar akses dhe informim në kohë reale;
3. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencën dhe kualifikimet e duhura, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit;
4. Përdorimi i metodave interaktive dhe përfshirja e studentëve në këtë proces, evidentohet si një pikë e fortë e këtij programi studimi;
5. Angazhim gjithnjë e në më shumë projekte kërkimore të financuara brenda dhe jashtë vendit.
6. Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore , si klasa, laboratorë salla të pajisura me kompjutera, projektor, smart board, lidhje internet të përshtatshme për nevojat e zhvillimit të orëve mësimore, të programit bachelor të Shkenca Politike me profile.
7. UniBa është një institucion me përvojë disa vjeçare dhe ka nënshkruar marrëveshje me një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, duke mundësuar cilësi të lartë të mësimdhënies dhe kryerjen e praktikave profesionale.

Pika të dobta:

1. Rënia e interesit të maturantëve për këtë program studimi fakt i reflektuar nëpërmjet numrit në rënie të studentëve ndër vite.
2. Konkurrenca nga IAL-t që ofrojnë programe studimi të ngjashme.
3. Personeli akademik efektiv duhet të avancojë me tituj dhe grada pasi katër prej tyre janë vetëm Msc.(standardi 1; kriteri 4)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që të punohet për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas duke marrë në konsiderat sfidat që ka ky profil studimi;
2. Sugjerohet që departamenti që ofron këtë program studimi të ndërmarrë një studim cilësor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepen të gjitha analizat, statistikat, rezultatet dhe alternativat mbi bazën e së cilës do të mund të këtë vijueshmëri dhe aftësi konkurruese si program studimi;
3. Staf akademik të nxitet për të punuar në fushën e kërkimit shkencor për marrjen e gradës Doktor, dhe të realizojë më shumë produkte si artikuj shkencor në revista shkencore, si brenda edhe jashtë vendit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program bachelor in "Political Science" with a profile in Public Administration and International Relations provided by the Higher Education Institution " Barleti University "

Strengths and affirmations

1. The university has a comprehensive legal and regulatory framework that enables the implementation of the teaching, research, and scientific processes, along with a very good practice of document preservation according to the applicable legal and sub-legal standards and requirements.
2. UniBa also utilizes digital platforms that assist students by providing real-time access and information.
3. The academic staff involved in the study program possesses the necessary experience and qualifications to fulfill the objectives of the study program.
4. The use of interactive methods and the involvement of students in this process is highlighted as a strong point of this study program.
5. Increasing engagement in research projects funded both domestically and internationally.
6. The institution ensures sufficient and suitable environments for the development of teaching activities, such as classrooms, laboratories, computer-equipped halls, projectors, smart boards, and internet connections suitable for the needs of the Political Science bachelor's program.
7. UniBa is an institution with several years of experience and has signed agreements with a wide network of collaborators at the local, regional, and international levels, enabling high-quality teaching and the implementation of professional internships.

Weak points:



1. The decline in interest from high school graduates in this study program, as reflected in the decreasing number of students over the years.
2. Competition from higher education institutions offering similar study programs.
3. The academic staff needs to advance with titles and degrees, as four of them only hold an MSc (Standard 1; Criterion 4).

Recommendations:

1. GVJ recommends focusing on identifying effective strategies for more efficient promotion and marketing, taking into consideration the specific challenges faced by this study program profile.
2. It is suggested that the department offering this program conduct a comprehensive qualitative and quantitative market analysis, providing detailed insights, statistics, results, and alternatives that will support the program's sustainability and competitive positioning.
3. The academic staff should be encouraged to engage in scientific research towards obtaining a Doctorate degree and to produce more scholarly outputs, such as scientific articles in peer-reviewed journals, both nationally and internationally.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

